



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Programi i Studimit me Karakter Profesional në “Kontabilitet”**

**Universiteti European i Tiranës**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

**Prof. As. Dr. Rezarta Perri**

**Dr. Valbona Kapllani**

**Shtator / 2021**

**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**

**ME KARAKTER PROFESIONAL NË “KONTABILITET”**

1	IAL aplikues:	Universiteti Europian i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Ekonomiksit dhe Financws
3	Emërtimi i programit të studimit:	Program me karakter profesional në: “ Turizëm”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër Nr. 545, datë 10.09.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Program me karakter profesional
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 5
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	20 PAE / 1 PAK
18	Numri i studentëve:	28 studentë
19	Komente / të tjera:	-

## **PËRMBLEDHJE E TE DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Programi i studimit “Diplomë Profesionale në Kontabilitet” është hapur me Urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Nr. 545, datë 10.09.2018. Ky program mbulohet nga Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës, në Fakultetin e Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit, të Universitetit Europian të Tiranës (UET), i licencuar me VKM Nr. 255, datë 27.02.2008 dhe i riorganizuar me Urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Nr. 527, datë 04.09.2018.

Programi i studimit “Diplomë Profesionale në Kontabilitet” është i organizuar në dy vite akademike dhe realizohet me 120 kredite (ECTS). Ai ofrohet në gjuhën shqipe dhe me formë studimi me kohë të plotë. Në përfundim të studimeve në këtë program studentët pajisen me Diplomë Profesionale në “Kontabilitet”, në përputhje me nivelin 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Objektivi kryesor i këtij programi është formimi i specialistëve të fushës së kontabilitetit dhe financës me një fokus të vecantë në aktivitetet praktike të profesionit kontabël. Qëllimi i programit është të formojë specialistë të cilët do të jenë në gjendje të punojnë në njësi private dhe publike në fushën e gjerë të financës dhe në mënyrë të veçantë në kontabilitet. Programi synon të pajisë studentët me njohuri dhe dije nga fushat e financës, kontabilitetit si edhe më gjerë, nga disiplinat shoqëruese të tyre me qëllim aftësimin e studentëve për të komunikuar dhe ndërvepruar lirisht në ambiente pune dinamike dhe në ndryshim të vazhdueshëm.

Programi i studimit “Diplomë Profesionale në Kontabilitet” është hapur në vitin 2018 dhe për vitin akademik 2018 – 2019, në këtë program janë regjistruar 7 studentë; për vitin akademik 2019 – 2020 janë regjistruar 26 studentë dhe për vitin akademik 2020 – 2021 janë regjistruar 5 studentë.

## **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Në datën 21.05.2021, Universiteti Europian i Tiranës (UET) ka aplikuar për nisjen e procedurës së akreditimit të programit Diplomë Profesionale në "Kontabilitet" nëpërmjet shërbimit në AMS. ASCAL bazuar në *"Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017"* ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga UET, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm.

Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje Prof. Asoc. Dr. Rezarta Shkurti dhe Dr. Valbona Kapllani, pedagogje pranë Fakultetit të Ekonomisë, të Universitetit të Tiranës, Departamenti i Kontabilitetit. Gjatë të gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Znj. Majlinda Demirneli.

Ekspertëve të jashtëm iu vendos në dispozicion i gjithë dokumentacioni i dorëzuar nga institucioni për vlerësim. Pas një kohe në dispozicion të ekspertëve për të studiuar dokumentat dhe për të përpiluar pyetjet apo paqartësitë e tyre, u përcaktua edhe agjenda e vizitave në institucion, të cilat u zhvilluan në datat 5 dhe 6 korrik 2021 në ambientet e UET. Gjatë vizitave ekspertëve iu vendos në dispozicion një sallë mbledhjesh për të kryer të gjitha takimet sipas agjendës së planifikuar. Dokumentacioni shtesë i kërkuar nga ekspertët u vu në dispozicion në datën 12 korrik 2021.

Pas rishikimit të dokumentacionit të institucionit dhe intervistave me pyetje të përcaktuara të ekspertëve, GVJ paraqet si më poshtë vlerësimin e tij sipas standardeve dhe për çdo kriter që i referohet standardit për programin e studimit Diplomë Profesionale në "Kontabilitet".

Ky raport është përpiluar në bashkëpunim mes dy ekspertëve të jashtëm dhe paraqet mendimet e tyre të integruara.

Universiteti Europian i Tiranës është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 20.09.2021, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 19/73 Prot, datë 20.09.2021. Universiteti Europian i Tiranës përcjell në ASCAL më datë 22 Shtator, me anë të shkresës me Nr. 78/48 Prot, datë 22.09.2021, "Kthim përgjigje mbi draft raportin e vlerësimit të jashtëm", ku konfirmon dakortësinë me vlerësimin e kryer nga ekspertët e jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

## Vlerësimi i Programit të Studimit me karakter profesional “Kontabilitet”

### I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi me karakter profesional në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij dhe në përputhje me nevojat e kërkesat e tregut të punës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	<p>Për të gjykuar mbi shkallën e përmbushjes së këtij kriteri, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (në vijim GVJ), shqyrtoi Statutin e Institucionit (viti 2017), Planin Strategjik të Institucionit (2021-2025), si edhe Planin Strategjik të Zvillimit të Programit të Studimit. Referuar Statutit të Universitetit European të Tiranës (UET), Neni 6, qëllimi i Institucionit është të jetë një Institucion lider për zhvillimin e dijes në shoqërinë shqiptare. Misioni i UET është t’u japë studentëve një edukim cilësor që përfshin kërkim cilësor shkencor, mësimdhënie, krijimtari dhe bashkëpunim me aktorët e tregut të punës. Në funksion të vizionit dhe misionit të tij, UET ka disa objektiva strategjike, ndër të cilat edhe “pajisjen e studentëve të diplomuar me edukimin më të mirë dhe mundësi që ata të rrisin dijet, aftësitë dhe eksperiencën e tyre”. Në planin strategjik të UET për vitet 2021-2025 (pika I.1), theksohet “zhvillimi profesional i studentëve nëpërmjet bashkëpunimit me industrinë dhe institucionet e tjera apo duke angazhuar ekspertë të jashtëm në auditore”. GVJ konstaton se programi i studimit me karakter profesional në Kontabilitet në UET është i konceptuar në përputhje me qëllimin dhe misionin e Institucionit dhe shihet si një mjet për arritjen e synimeve strategjike të tij.</p> <p>[Referenca: 2. Statuti UET.pdf; 3.3 PLANI STRATEGJIK UET_2021.pdf; 4. Plani strategjik për zhvillimin e programit - DP Kontb.pdf]</p>
<b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit duhet të përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe të demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	<p>GVJ shqyrtoi Statutin e Institucionit (neni 6.1) në të cilat konstatoi të formuluarat qartë drejtimit prioritar akademike të Institucionit të cilat janë: studimet shoqërore – politike, ekonomike, juridike, të edukimit e teknologjisë së informacionit. Diploma Profesionale në Kontabilitet e ofruar nga UET është pikërisht në përputhje me drejtimin e studimeve ekonomike të Institucionit. Më tej, sipas Rregullores së Institucionit, pika 3.6, shihet se Institucioni ofron programe të studimeve profesionale me 60 ose 120 kredite. Për shkak të përputhjes me këto</p>

	<p>specifikime, GVJ e konsideron të përmbushur plotësisht këtë kriter.</p> <p>[Referenca: 2. Statuti UET.pdf; 5. Rregullore e UET.pdf]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit, si dhe fushën akademike të njësisë kryesore/kolegjit profesional dhe atë të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit.</p>	<p>Sipas Statutit të Institucionit, fushat prioritare akademike të UET janë: studimet shoqërore – politike, ekonomike, juridike, të edukimit dhe ato të teknologjisë së informacionit dhe në këtë këndvështrim programi i studimeve profesionale në Kontabilitet ofrohet në përputhje me këtë gamë të drejtimeve akademike. Programi i studimit ofrohet nga Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit si njësi kryesore dhe Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës si njësi bazë. GVJ konstaton se profili i njësisë kryesore dhe njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit përputhen dhe garantojnë ofrimin e programit të studimit me karakter profesional në Kontabilitet.</p> <p>[Referenca: 2. Statuti UET.pdf; 5. Rregullore e UET.pdf]</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Propozimi, hartimi dhe realizimi i programit të studimit me karakter profesional mbështetet në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe.</p>	<p>Për këtë kriter, Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (në vijim RVB) i paraqitur nga Institucioni thjesht deklaron se programi i studimit është mbështetur në studimin e tregut kombëtar të punësimit por pa dhënë referenca të nevojshme të dokumentave përkatëse në Dosjen e Vetë Vlerësimit (në vijim DVV).</p> <p>Për këtë arsye, GVJ analizoi dokumentacionin në DVV dhe ndeshi në dokumentin e titulluar “Argumentet për propozimin për hapjen e programit”, i cili në vetvete megjithatë nuk mjafton të konsiderohet si studim i mirëfilltë tregu në funksion të programit të studimit “Diplomë Profesionale në Kontabilitet”. Gjatë vizitës në Institucion, GVJ kërkoi të dinte më shumë për mënyrën sesi Institucioni studion tregun lokal dhe kombëtar të punësimit. Drejtuesit e IAL pranuan se mungon një studim i mirëfilltë tregut për këtë program studimi, e justifikuar kjo edhe për shkak të vështirësive të viteve të fundit. Ajo që realizohet më së shumti nga Institucioni është një komunikim informal me bizneset me të cilat ekzistojnë marrëveshje bashkëpunimi, edhe nëpërmjet Bordeve të Tregut të Punës të cilat janë pjesë e Institucionit. Nëpërmjet takimeve me këto Borde janë ezauruar hetimet e perceptimit të tregut për të marrë sinjalet e nevojshme mbi nevojat e punëdhënësve.</p> <p><i>GVJ sugjeron, se në të ardhmen IAL mund të punojë më mirë në drejtim të formalizimit dhe dokumentimit të këtyre diskutimeve dhe analizave të cilat për momentin ndeshen më së shumti në një trajtë informale.</i></p> <p>[Referenca: 0. RVB_DP Kontabilitet.pdf; 16. Argumentimi per</p>

	<i>hapjen.pdf</i>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Gjatë realizimit të programit të studimit, nga pranimi në diplomim dhe pas daljes së studentëve në punë, zhvillohen studime periodike mbi tregun e punës, ndryshimet përkatëse dhe punësimin e studentëve.</p>	<p>Institucioni referon se në përgjithësi e ka si traditë të tijën që mban kontakte të ngushta me tregun e punës dhe punëdhënësit potencialë duke shfrytëzuar dy instrumenta:</p> <p>1 - Ngritjen dhe funksionimin e Bordit të Punës;</p> <p>2 – Kontaktet e vazhdueshme me bizneset me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi në kuadrin e kryerjes së praktikave profesionale;</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Studimet paraprake dhe periodike të tregut të punës për programet me karakter profesional duhet të përfshijnë të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Sipas RVB për këtë kriter, lista e marrëveshjeve institucionale jepet në (<i>evidencën 34 në DVV</i>), por GVJ konstaton se ajo nuk është një listë specifike për programin e studimit “Diplomë Profesionale në Kontabilitet”. Një listë e marrëveshjeve të bashkëpunimit në funksion të programit të studimit të shqyrtuar u gjet nga GVJ dhe është (<i>evidenca 32 “Lista e subjekteve bashkëpunuese”</i>).</p> <p>Studimi periodik i tregut të punës si parim ende nuk mund të realizohet për shkak se ka pasur vetëm dy të diplomuar nga ky program në vitin akademik 2019 – 2020 nga të cilët një prej tyre është i punësuar në profesion. Institucioni angazhohet se ka vullnetin të kryejë studime periodike të tregut të punës në përputhje me praktikat më të mira të tij. Struktura e cila mban kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar referohet se është Zyra e Pranimeve, Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit dhe është përgjegjësi e kësaj zyre të ndjekë ecurinë dhe të mbajë statistika për punësimin dhe zhvillimin profesional të studentëve. Këto përfshihen edhe studentët e këtij programi studimi të cilët priten të diplomohen këtë vit dhe vitet në vazhdim. Gjatë vizitës në Institucion, gjatë intervistave me punonjës të kësaj zyre, GVJ konstatoi veprime konkrete nga ana e kësaj strukture për të mbajtur kontakte me studentët e diplomuar dhe për t’i angazhuar ata vazhdimisht në aktivitete të organizuara nga Institucioni.</p> <p><i>[Referenca: 0.2. Aneks - Tabelat mbështetëse - DP Kontb.pdf; 12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.pdf; 12.2 Bordi i tregut te punes 2019-2020.pdf; 17. Analize e tregut te punes.pdf; 34. Marreveshje bashkepunimi UET.pdf]</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

## Standardi I.2

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit dhe me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, dhe në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit të DVV dhe në mënyrë më specifike, Statutin e UET, Rregulloren e UET dhe Rregulloren e programit të studimit Diplomë Profesionale në Kontabilitet, GVJ formoi opinionin se Institucioni ka ngritur një strukturë të qartë të organizimit të brendshëm të njësive përbërëse të tij. Ndarja e detyrave dhe përgjegjësive mes stafit akademik dhe atij administrativ është përgjithësisht e qartë duke e lejuar institucionin të arrijë kryerjen e aktiviteteve të nevojshme.</p> <p><i>Një element i konstatuar nga GVJ megjithatë ishte mbivendosja e detyrave akademike dhe atyre administrative tek i njëjti pozicion pune. Shumë prej personelit akademik të intervistuar gjatë vizitës në Institucion u shprehën se përveç orëve mësimore ata kishin edhe një rol tjetër si punonjës të zyrave të ndryshme të Institucionit. Duke menduar që kjo e ngarkon personelin akademik përtej kërkesave të pozicionit të tij si staf pedagogjik, GVJ këshillon që kjo praktikë të rishikohet nga ana e Institucionit.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave të procesit mësimor, formimin teorik e praktik të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie afatgjata e të qëndrueshme bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, me punëdhënës vendës, aktorë të biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>GVJ konstaton se UET karakterizohet nga një larmi marrëveshjesh me Institucione partnere, si Universitete të huaja dhe vendase, agjensi dhe ente qeveritare, njësi biznesi, etj. Institucioni është kujdesur që të dorëzojë si pjesë e DVV edhe marrëveshjet konkrete të lidhura mes palëve duke i dhënë mundësi GVJ të gjykojë mbi fushën e zbatimit dhe objektin e këtyre marrëveshjeve. Nga analiza e evidencave 34.1 – 34.9 në DVV, GVJ formoi opinionin se këto marrëveshje në një pjesë të mirë të tyre mbulojnë aspekte të nevojshme të realizimit të objektivave teorike dhe praktike të programit të studimit “Diplomë Profesionale në Kontabilitet”.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Lista e plotë e marrëveshjeve në funksion të realizimit të objektivave të procesit mësimor dhe formimit teoriko – praktik të studentëve (në evidencën 32 “Lista e subjekteve bashkëpunuese”) parashtron edhe detaje mbi praktikën profesionale në funksion të programit të studimit “Diplomë Profesionale në Kontabilitet”, si koha e kryerjes së praktikës, qëllimi dhe objektivat e saj, dokumentat mbështetëse, raportet</p>



	që do të plotësohen si produkt i praktikës, etj. [Referenca: 32. Lista e subjekteve bashkepunuese.pdf]			
<b>Kriteri 3.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	Në RVB të paraqitur nga Institucioni për këtë kriter referohet se UET, në përputhje me strategjinë e programit të studimit ka përgatitur dokumentin “Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit”, por pa vendosur një numër reference të këtij dokumenti. GVJ shqyrtoi dokumentacionin e DVV dhe ndeshi evidencën 35 ku bëhej një prezantim i përmbledhur – vetëm një faqe – i cilësisë së marrëdhënieve me partnerët dhe përmend disa aktivitete dhe praktika të mira në këtë kontekst.  <i>GVJ nuk mund të konsiderojë një dokument të tillë si raport krejtësisht analitik dhe këshillon që në të ardhmen, me zgjerimin e praktikave të bashkëpunimit përtej kushteve të pandemisë që ka mbizotëruar për pjesën më të madhe të periudhës së ofrimit të studimeve për këtë program, të përmirësohet dhe cilësia e këtyre raporteve analitike.</i>  [Referenca: 0. RVB_DP Kontabilitet.pdf; 35. Raport analitik i përfitimeve nga marreveshjet e bashkepunimit.pdf]			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni ndërmerr iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve.	Struktura Institucionale e UET që është përgjegjëse për mbështetjen e studentëve, iniciativat dhe punësimin e tyre është Zyra e Pranimeve, Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit të Studentëve. Të pyetur gjatë vizitës në Institucion përfaqësues të kësaj zyre, konfirmuan përkjekjet e vazhdueshme të Institucionit në drejtim të punësimit të studentëve. Aktivitete si Panairi i Punës u japin mundësi praktike të gjithë studentëve të vijnë në kontakt me punëdhënës potencialë pikërisht në ambientet e Institucionit.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi I.3

**Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi dhe Kuadrin Evropian e Shqiptar të Kualifikimeve për këto programe studimi.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve janë të organizuara në lëndë/module dhe të vlerësuara në	Programi i Studimit “Diplomë Profesionale në Kontabilitet” është i organizuar si një program profesional me 120 kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të

<p>kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Krediteve (ECTS) dhe paraqitet në përputhje me kërkesat e legjislacionit vendas për organizimin e programeve profesionale, më konkretisht Ligjit për Arsimin e Lartë 80/2015 dhe VKM nr 41/2018 të ndryshuar.</p> <p><i>[Referenca: 7. Rregullore e programit të studimit_ DP Kontabilitet.pdf; 32. Lista e subjekteve bashkepunuese.pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve me karakter profesional synojnë përfitim të njohurive gjithë përfshirëse të specializuara teorike dhe praktike brenda një fushe punësimi në një llojshmëri të gjerë profesionale dhe specialitetesh.</p>	<p>Objektivi i Programit të Studimit “Diplomë Profesionale në Kontabilitet” është të aftësojë studentët për t’u punësuar si asistentë financë apo kontabiliteti / auditimi. Nga analiza e përmbajtjes së Planit Mësimor verifikohet se mënyra e strukturimit dhe ndërlikohjes së lëndëve të programit, rrjedha e njohurive të dhëna për studentët sipas semestrave dhe sipas viteve (Rregullorja e Programit të Studimit, aneksi 2) synojnë të përcjellin tek studentët njohuri të kompletuara në fushën e kontabilitetit financiar dhe kontabilitetit të kostos si edhe fusha të ndërthurura me to. Bazuar në këtë konstatim, GVJ gjykon se programi i studimit ka si synim dhënien e njohurive për aftësimin e studentëve në profesionin përkatës.</p> <p><i>[Referenca: 7. Rregullore e programit të studimit_ DP Kontabilitet.pdf; 14.1. Plani mesimor i programit të studimit - DP Kontabilitet.pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit me karakter profesional synojnë pajisjen e studentëve me një sërë aftësish njohëse dhe praktike gjithëpërfshirëse që nevojiten për të zgjidhur në mënyrë krijuese probleme të karakterit profesional praktik.</p>	<p>Nga analiza e përmbajtjes së programeve lëndore të programit të studimit “Diplomë Profesionale në Kontabilitet”, GVJ formoi opinionin se elementet dhe çështjet e transmetuara nëpërmjet lëndëve të ndryshme synojnë të transmetojnë tek studentët aftësi profesionale për t’u përballur me çështje dhe problematika të praktikave kontabël në vendin tonë. Lëndë si “Parimet e Kontabilitetit”, “Sistemet e Informacionit Kontabël”, dhe “Taksimi” i pajisin studentët me aftësi për të realizuar mbajtjen e kontabilitetit në ndërmarrje shqiptare (por jo vetëm) dhe të punësohen në të ardhmen në pozicione si asistent finance/kontabiliteti/auditimi siç janë edhe profesionet e synuara të kësaj diplome (Rregullorja e Programit të Studimit, aneksi 1). Gjithashtu, lëndë në planin mësimor si “Hyrje në Menaxhimin e Burimeve Njerëzore” “Hyrje në Menaxhimin e Riskut” “Hartim dhe Menaxhim Projektesh” i aftësojnë studentët të pajisen me kompetenca menaxheriale dhe të përballen me situata të ndryshueshme. Kriteri përmbushet plotësisht.</p> <p><i>[Referenca: 7. Rregullore e programit të studimit_ DP Kontabilitet.pdf; 14.1. Plani mesimor i programit të studimit - DP Kontabilitet.pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit me karakter profesional synojnë zhvillimin e kompetencave për menaxhimin dhe mbikëqyrje në kuadrin e veprimtarive profesionale dhe orientimin e duhur në situata të ndryshme e të ndryshueshme.</p>	<p>Nga analiza e përmbajtjes së programeve lëndore të programit të studimit “Diplomë Profesionale në Kontabilitet”, GVJ formoi opinionin se elementet dhe çështjet e transmetuara nëpërmjet lëndëve të ndryshme synojnë të transmetojnë tek studentët aftësi profesionale për t’u përballur me çështje dhe problematika të praktikave kontabël në vendin tonë. Lëndë si “Parimet e Kontabilitetit”, “Sistemet e Informacionit Kontabël”, dhe “Taksimi” i pajisin studentët me aftësi për të realizuar mbajtjen e kontabilitetit në ndërmarrje shqiptare (por jo vetëm) dhe të punësohen në të ardhmen në pozicione si asistent finance/kontabiliteti/auditimi siç janë edhe profesionet e synuara të kësaj diplome (Rregullorja e Programit të Studimit, aneksi 1). Gjithashtu, lëndë në planin mësimor si “Hyrje në Menaxhimin e Burimeve Njerëzore” “Hyrje në Menaxhimin e Riskut” “Hartim dhe Menaxhim Projektesh” i aftësojnë studentët të pajisen me kompetenca menaxheriale dhe të përballen me situata të ndryshueshme. Kriteri përmbushet plotësisht.</p> <p><i>[Referenca: 7. Rregullore e programit të studimit_ DP Kontabilitet.pdf; 14.1. Plani mesimor i programit të studimit - DP Kontabilitet.pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni/njësia</p>	<p>GVJ analizoi të dhënat e raportuara nga Institucioni në RVB dhe</p>

kryesore/kolegji profesional dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë të organizimit, strukturës akademike dhe numrit e shkallës së kualifikimit të stafit akademik.

tabelat mbështetëse dhe konstatoi se Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit i cili është njësia kryesore që është përgjegjëse për këtë program studimi përmbush kërkesat ligjore për hapjen dhe organizimin e tij.

Ky Fakultet është krijuar me VKM nr.255 dt. 27.2.2008 dhe është riorganizuar me Urdhër të Ministrit nr.527, dt. 4.9.2018 kur mori edhe emrin aktual që ka. Universiteti Europian i Tiranës është institucion i akredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit nr.12 dt. 7.4.2017 si dhe Vendim nr.46, dt. 5.7.2019.

Mbështetur në kërkesat e nenit 23 të ligjit të Arsimit të Lartë: “fakulteti organizohet në së paku tri njësi bazë, së paku dy prej të cilave janë departamente”, GVJ konfirmon se Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit i UET, e plotëson këtë kërkesë pasi aktualisht është i organizuar në dy departamente/njësi bazë dhe një qendër:

- Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës;
- Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut;
- Qendra për Zhvillim të Qëndrueshëm;

Referuar dokumentacionit të dorëzuar (evidenca 23 në DVV), në vitin e fundit akademik **2020-2021**, Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit i UET nga **33 staf gjithsej**, ka 29 Personel Akademik Efektiv (pra 88% të stafit total), 4 Personel Akademik me Kontratë (12% të stafit total). Për vitin **2020 – 2021 detajimi i stafit sipas gradeve dhe titujve:**

Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit	2020-2021	
	PAE	PAK
Prof.Dr	3	1
Prof.As	5	
Dr	10	3
MSc	11	
<b>Total</b>	<b>29</b>	<b>4</b>
<b>PNA</b>		<b>0</b>

*Për vitet e tjera akademike, nuk jepen të dhëna në RVB ne lidhje me numrin e stafit PAE dhe PAK për njësinë kryesore.*

Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit i UET ofron gjithsej 14 programe studimi (evidenca 26 në DVV): 3 programe studimi profesionale, 3 programe studimi në nivelin bachelor, 3 programe studimi në Master i Shkencave, 4 programe studimi në Master Profesional dhe 1 program në nivel të shkollës së Doktoratës. Referuar të dhënave shoqëruese të DVV (Tabela 2

në evidencën 23), si edhe pas konfirmimit gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstaton se Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës, njësia bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit “Diplomë Profesionale në Kontabilitet”, përmbush kërkesat ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të stafit (më specifikisht, ka minimumi 7 pedagogë të brendshëm nga të cilët të paktën 3 janë me tituj/grada) për të tre vitet akademike për të cilat kërkohet akreditimi.

(Të dhëna analitike në lidhje me përbërjen e stafit të Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës në vitet e fundit paraqiten më poshtë):

Dep i Ekonomiksit e Financës	2018-2019		2019-2020		2020 – 2021	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr	3		1	1	1	1
Prof.As	5		3	1	3	
Dr	3	3	3	2	4	
MSc	7	3	7	4	6	
<b>Total</b>	<b>18</b>	<b>6</b>	<b>14</b>	<b>8</b>	<b>14</b>	<b>1</b>
<b>PNA</b>	<b>0</b>		<b>0</b>		<b>0</b>	

*Nga tabela e mësipërme, GVJ konstaton një pakësim gradual por të qendrueshëm, të stafit të Departamentit të Ekonomiksit dhe Financës. Të pyetur për këtë gjatë vizitës në Institucion, drejtues të tij u shprehën se kjo ka ardhur si pasojë e ndryshimeve organike nga ana e personelit të punësuar por, edhe si reflektim i pakësimit të numrave të studentëve të regjistruar në programet e studimit me profil ekonomik. Disa profile master janë mbyllur për shkak të numrit të ulët të studentëve dhe si rrjedhim është ulur edhe numri i klasave dhe stafit.*

*[Referenca: 0. RVB\_DP Kontabilitet.pdf; 5. Rregullore e UET.pdf; 23. Të dhëna Tabelore për personelin akademik.pdf; 26. Te dhena per numrin e programeve te studimit qe ofrohen nga njesia pergjegjese.pdf; vizita në institucion]*

**Kriteri 6.** Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.

Objektivat e Programit të Studimit “Diplomë Profesionale në Kontabilitet” i gjejmë të parashtruara në pikën 3.3 të Rregullores së Programit të Studimit. Ndër këto objektiva GVJ përmend disa synime të programit si: pajisjen e studentëve me njohuri dhe koncepte bazë të fushës së kontabilitetit; afësim drejt një profesioni ose license profesionale; aftësi bazë për punë kërkimore aplikative; aftësi të përgjithshme praktike dhe aftësi për promovim dhe avancim profesional. Bazuar në këto objektiva, si edhe në komponentët e tjerë të programit të

	studimit, si kompetencat (të përfshira në programet lëndore,) GVJ gjykon se janë konceptuar dhe përmbledhur në mënyrë të qartë dijet, aftësitë dhe kompetencat që studentët duhet të fitojnë në përfundim të programit. <i>[Referenca: 7. Rregullore e programit të studimit_ DP Kontabilitet.pdf]</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

<b>Standardi II.1</b>	
Programet e studimeve me karakter profesional janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të këtij niveli dhe mundësitë e punësimit.	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit me karakter profesional, përmbajnë dhe japin informacionet e nevojshme për objektivat formues, rezultatet e pritshme të të nxënies, organizimin, strukturën, përmbajtjen, fushat e mundshme të punësimit apo të dhëna reale të punësimit të studentëve të diplomuar në këto programe.	Rregullorja e Programit të Studimit së bashku me anekset shoqëruese të saj parashtrajnë elementet e nevojshme të programit si objektivat formues (pika 3.3), organizimin e programit dhe strukturën e tij (pika 3.1), përmbajtjen (aneksi 2), fushat e mundshme të punësimit (aneksi 1), duke bërë që GVJ të konsiderojë këtë kriter të përmbushur plotësisht. Në lidhje me pjesën e dytë të kriterit, pra me të dhënat reale të punësimit të studentëve të diplomuar në programin e studimit, siç u parashtrua edhe më lart në këtë RVJ, deri në kohën e hartimit të këtij raporti (korrik 2021) programi ka vetëm dy të diplomuar gjatë vitit akademik 2019 – 2020, nga të cilët është i punësuar në përputhje me profilin e studimeve një prej tyre. (ky informacion jepet në evidencat 17 dhe 29 në DVV).  <i>[Referenca: 7. Rregullore e programit të studimit DP Kontabilitet.pdf; 17. Analize e tregut të punës.pdf; 29. Tabele përmbledhese për punësimin real të studentëve.pdf; vizita në institucion]</i>

**Kriteri 2.** Programet e studimit janë të organizuara në module/lëndë e aktivitete formuese, të vlerësuara me kredite, të ndara në vite e semestra e që janë në përputhje me përcaktimet vendëse e evropiane në fuqi.

Bazuar në shqyrtimin e Planit Mësimor të Programit të Studimit “Diplomë Profesionale në Kontabilitet” në UET, GVJ konstaton se ky program studimi është i organizuar në module të detyrueshme dhe përmban praktikë profesionale e aktivitete formuese sipas kërkesave të ligjit nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë. Mësimi është i organizuar në dy vite akademike me dy semestra që kanë kohëzgjatje normale 15 javë mësimore. Programi i plotë shtrihet në 4 semestra, në të cilin trajtohen lëndët të cilat janë të vlerësuara me kredite sipas sistemit evropian, ECTS.

Ndarja në kategoritë e aktiviteteve formuese A - E është si më poshtë:

- **Kategoria A** (lëndët e formimit të përgjithshëm /bazë): – gjithsej **21 ECTS, pra 18% e totalit** (duhet të jetë 10 % – 15% e totalit, sipas VKM nr. 879, datë 18.12.2019, e ndryshuar, tabela 1.1)
- **Kategoria B** (lëndë të formimit karakterizues: gjithsej **54 ECTS, pra 48% e totalit**, (duhet të jetë 45% - 55% sipas VKM nr. 879, datë 18.12.2019, e ndryshuar, tabela 1.1)
- **Kategoria C** (lëndë ndërdisiplinore, profile dhe grup-lëndësh me zgjedhje): gjithsej **18 ECTS, pra 15% e totalit** (duhet të jetë 5 % – 15% e totalit sipas VKM nr. 879, datë 18.12.2019, e ndryshuar, tabela 1.1)
- **Kategoria D** (lëndë plotësuese dhe praktika profesionale): gjithsej **18 ECTS, pra 15% e totalit** (duhet të jetë 10 % – 15% e totalit sipas VKM nr. 879, datë 18.12.2019, e ndryshuar, tabela 1.1)
- **Kategoria E** (detyrimet përmbyllëse: projekti i diplomimit ose provimi përfundimtar gjithëpërfshirës): gjithsej **5 ECTS (4%) e totalit** (duhet të jetë 3 % – 5% e totalit sipas VKM nr. 879, datë 18.12.2019, e ndryshuar, tabela 1.1),

GVJ këshillon rishikimin e lëndëve të kategorisë A duke hequr apo lehtësuar ndonjë prej tyre (psh., Matematikë) në mënyrë që të arrihet në kufijtë e intervalit të parashikuar nga VKM nr. 879, datë 18.12.2019, e ndryshuar.

[Referenca: 7. Rregullore e programit të studimit DP Kontabilitet.pdf; 14.1. Plani mesimor i programit të studimit - DP Kontabilitet.pdf; 14.2. Plani mesimor i ndare sipas veprimtarive formuese - DP Kontabilitet.pdf; vizita në

	<i>institucionj</i>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ndjekjen e programit, vlerësimin e dijeve, aktivitete specifike etj.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët e aktivitetet formuese të programit të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV, dhe më specifikisht Planin Mësimor të Programit të Studimit “Diplomë Profesionale në Kontabilitet” dhe programet lëndore konkrete, GVJ konstaton se në to jepen informacionet e nevojshme në lidhje me orët në auditor dhe jashtë tij për çdo lëndë, shkallën e frekuentimit të programit, dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve. Vlerësimi i dijeve bëhet në mënyrë të vazhdueshme sipas komponentëve të mëposhtëm (pika 5.2 e rregullores së programit të studimit)</p> <p style="text-align: center;"><b><i>Për lëndët e Tipologjisë I</i></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Provimit përfundimtar (40%)</li> <li>▪ Detyrave praktike: 2 (dy) x 30% = (60%)</li> </ul> <p style="text-align: center;"><b><i>Për lëndët e Tipologjisë II</i></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Provimit përfundimtar (40%)</li> <li>▪ Provimit të ndërmjetëm (30%)</li> <li>▪ Detyrë kursi (20%)</li> <li>▪ Nivelit të diskutimit në seminare (10%)</li> </ul> <p>Në bazë të Rregullorës së Programit të Studimit, detyrim frekuentimi është 60% e orëve në auditor.</p> <p>Në analizën e syllabuseve të detajuar, GVJ konstatoi se për secilën lëndë shpjegoheshin qartë praktikat, seminarët dhe aktivitetet e tjera formuese të nevojshme. Vetë syllabuset ishin të strukturuar në përputhje me kërkesat e shtojcës nr.2 të VKM 41/2018 i ndryshuar pra përmbanin rezultatet e të nxëniet, konceptet themelore, temat, format e kontrollit të dijeve, frekuentimin, kontrollin e vazhdueshëm si edhe literaturën me faqet përkatëse.</p> <p><i>[Referenca: 7. Rregullore e programit te studimit DP Kontabilitet.pdf; 19.1 Formati i Syllabusit Cikli i pare dhe i dyte.pdf; 19. Syllabus Tregjet financiare.pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Struktura dhe organizimi i programit të studimit është mjaftueshmërisht fleksibël për të mundësuar formimin e studentëve përgjatë programit dhe në përshtatje me punësimin.</p>	<p>Sipas Rregullores së Programit të Studimit “Diplomë Profesionale në Kontabilitet” (pika 10), programi, plani mësimor i tij, lëndët dhe veprimtaritë formuese që ofrohen si dhe kreditet për secilën prej tyre rishikohen në mënyrë periodike. Ndryshimet propozohen nga Departamenti, Zyra e Kurrikulave, por edhe nga anëtarë të personelit akademik, në konsultim me Bordet e Tregut të Punës, si përgjigje ndaj kërkesave të tregut të punës dhe dinamikave të brendshme. Propozimi shqyrtohet në Departament dhe nga Zyra e Kurrikulave dhe pastaj dërgohet për miratim në mbledhjen e Dekanatit. Sipas gjykimit të GVJ kjo praktikë</p>

	<p>garanton fleksibilitet për t'iu përshtatur ndryshimeve dhe zhvillimeve të reja në tregun e profesionit kontabël dhe nevojave për njohuri të reja që lindin vazhdimisht në këtë sektor.</p> <p>[Referenca: 7. Rregullore e programit të studimit DP Kontabilitet.pdf; vizita në institucion]</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Mësimi praktik dhe i elementeve të punës konkrete u është dhënë vendi dhe pesha e duhur në strukturë, vlerësim dhe rivlerësim.</p>	<p>GVJ konstaton se në programin e studimit “Diplomë Profesionale në Kontabilitet” i është dhënë një peshë e rëndësishme aktiviteteve formuese praktike dhe kjo jo vetëm nëpërmjet praktikës profesionale e cila është një lëndë e detyrueshme me 5 kredite që zhvillohet në vitin e fundit, por edhe me parashikimin e detyrave praktike dhe detyrave të shpeshta të kursit për çdo lëndë të programit (Rregullorja e Programit të Studimit, pika 5.7).</p> <p>Për lëndët e Tipologjisë I, parashikohet zhvillimi i 2 detyrave praktike në semester kryesisht në javën e 5-të dhe të 10-të të semestrit, ose në javën e 7-të dhe të 13-të, në varësi të specifikave të lëndës. Pedagogu i njofton studentët për tematikën e detyrave së paku dy javë para zhvillimit të tyre. Për lëndët e Tipologjisë II Detyra e kursit zhvillohet në klasë në javën e 13-të të semestrit, ose mbrohet në klasë në rastin kur është konceptuar si detyrë në grup.</p> <p>[Referenca: 7. Rregullore e programit të studimit DP Kontabilitet.pdf; 0.2. Aneks - Tabelat mbeshtetese - DP Kontb.pdf]</p>			
<p><b>Shkolla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Në përmbushje</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			X	

**Standardi II.2**

**Struktura, plani mësimor dhe shpërndarja lëndore e programeve të studimit me karakter profesional, është në përputhje me objektivat formuese, rezultateve të të nxënit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve dhe kërkesave të tregut të punës për këto programe.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, struktura dhe shpërndarja e në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore është në përputhje me parashikimet</p>	<p>Bazuar në shqyrtimin e Planit Mësimor të Programit të Studimit “Diplomë Profesionale në Kontabilitet” në UET, GVJ konstaton se ky program studimi është i emërtuar dhe i strukturuar në dy vite akademike dhe katër semestra që</p>



<p>ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>kanë kohëzgjatje normale 15 javë mësimore në përputhje me kërkesat ligjore (Ligji nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe VKM nr.41/2018).</p> <p>Vlerësimi i detajuar me kredite sipas aktiviteteve formuese A - E është paraqitur më lart në këtë raport (shiko kriteri II.1.2). Programi i studimit ofron gjashtë lëndë në çdo semestër akademik të vitit të parë dhe pesë lëndë në çdo semestër të vitit të dytë me 4 / 5 / 6 ECTS për secilën lëndë. Në semestrin e fundit studentët marrin pesë lëndë ku ndër të cilat janë pjesë edhe praktika profesionale dhe provimi i formimit / projekti profesional. “Praktika dhe zhvillimi” i studentit është lëndë e detyrueshme me 5 ECTS.</p> <p><i>[Referenca: 7. Rregullore e programit të studimit DP Kontabilitet.pdf; 14.1. Plani mesimor i programit të studimit - DP Kontabilitet.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, struktura dhe shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit, rezultateve të pritshme të të nxënësve dhe punësimin e studentëve.</p>	<p>GVJ mbështetur në shqyrtimin e përmbajtjes së Planit Mësimor të Programit të Studimit “Diplomë Profesionale në Kontabilitet”, si edhe analizën e detajuar të syllabuseve të lëndëve formoi opinionin se organizimi aktual i programit, në vite dhe semestra, orët mësimore të përcaktuara për çdo lëndë dhe vijimësia e lëndëve nga një semestër në tjetrin mundëson rritjen graduale profesionale të studentëve dhe si rezultat, arritjen e objektivave formuese të programit (aftësimin e studentëve për të punuar në profesionin e asistent/kontabilistit).</p> <p><i>[Referenca: 14.1. Plani mesimor i programit të studimit - DP Kontabilitet.pdf; 19. Syllabus Tregjet financiare.pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Plani mësimor, natyra dhe emërtimi i moduleve/lëndëve, syllabuset e moduleve e të aktiviteteve formuese janë informuese dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara.</p>	<p>GVJ mbështetur në shqyrtimin e përmbajtjes së Planit Mësimor të Programit të Studimit “Diplomë Profesionale në Kontabilitet”, si edhe analizën e detajuar të syllabuseve të lëndëve, konstatoi se ato përmbajnë të dhëna të plota dhe informuese në lidhje me elementet e nevojshme. Gjithashtu, sipas intervistave me studentët e programit të studimit, GVJ u vu në dijeni se këto elemente u bëheshin me dije edhe studentëve jo vetëm në fillimin e studimeve, por edhe në javën e parë të studimeve për çdo semestër.</p> <p><i>[Referenca: 14.1. Plani mesimor i programit të studimit - DP Kontabilitet.pdf; 19. Syllabus Tregjet financiare.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit</p>	<p>Përsa i përket strukturës së programit, në tabelën 13 në shtojcat e RVB gjendet informacion në shkallë të</p>

<p>teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësisht në praktikë/punë konkrete në profesion.</p>	<p>përmbledhur në lidhje me ngarkesën totale të programit të studimit.</p> <p>Nga kjo tabelë evidentohen elementet e mëposhtme të ngarkesës totale:</p> <table border="0"> <tr> <td>▪ Leksione</td> <td>420 orë</td> </tr> <tr> <td>▪ Seminare</td> <td>448 orë</td> </tr> <tr> <td>▪ Ushtrime / Laboratore</td> <td>- orë</td> </tr> <tr> <td>▪ Kontrolli i vazhdueshëm/praktika në auditor</td> <td>195 orë</td> </tr> <tr> <td>▪ Praktikë profesionale</td> <td>100 orë</td> </tr> <tr> <td>▪ Diploma/ Provim Formimi</td> <td>20 orë</td> </tr> <tr> <td><b>Totali</b></td> <td><b>1.183 orë</b></td> </tr> </table> <p>Raporti <b>Teori</b> (leksione) / <b>Praktikë</b> (sem+proj+prakt prof.) rezulton 420 orë teori / 763 orë praktikë, ose afërsisht <b>36% / 64%</b>.</p> <p>Vërejmë gjithashtu se rreth 27% e orëve të programit të studimit përbëhet nga praktika profesionale, projekti i formimit dhe praktika në auditor (315 orë gjithsej nga 1.183 orë në total).</p> <p>GVJ vlerëson pozitivisht peshën e konsiderueshme të orëve të praktikës ku përfshihen seminare dhe praktika në auditor dhe profesionale dhe konstaton se kjo është në përputhje me kërkesat e VKM nr. 879, datë 18.12.2019, e ndryshuar, tabela 1.1.</p> <p>[Referenca: 0.2. Aneks - Tabelat mbështetese - DP Kontb.pdf; 14.3. Plani mësimor sipas veprimtarive me karakter praktik – DP Kontabilitet.pdf]</p>	▪ Leksione	420 orë	▪ Seminare	448 orë	▪ Ushtrime / Laboratore	- orë	▪ Kontrolli i vazhdueshëm/praktika në auditor	195 orë	▪ Praktikë profesionale	100 orë	▪ Diploma/ Provim Formimi	20 orë	<b>Totali</b>	<b>1.183 orë</b>
▪ Leksione	420 orë														
▪ Seminare	448 orë														
▪ Ushtrime / Laboratore	- orë														
▪ Kontrolli i vazhdueshëm/praktika në auditor	195 orë														
▪ Praktikë profesionale	100 orë														
▪ Diploma/ Provim Formimi	20 orë														
<b>Totali</b>	<b>1.183 orë</b>														
<p><b>Kriteri 5.</b> Klasifikimi sipas aktiviteteve formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues dhe orientimin e studentit drejt studimeve të mëtejshme dhe/ ose në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>GVJ vlerëson pozitivisht peshën e konsiderueshme të orëve të praktikës ku përfshihen seminare, ushtrime, laboratore dhe praktika. Siç u tregua në mënyrë analitike në kriterin II.2.4 më lart, Programi i Studimit “Diplomë Profesionale në Kontabilitet” karakterizohet nga një peshë e konsiderueshme e orëve praktike – 64% ndjeshëm më e lartë se minimumi i kërkuar prej 50% (VKM nr. 879, datë 18.12.2019, e ndryshuar).</p> <p>Megjithatë, në kuadrin e sugjerimeve për përmirësimin e mëtejshëm të programit, GVJ nxjerr në pah <i>mungesën e orëve të laboratorit të cilat mund të ishin shfrytëzuar për t’u praktikuar me sistemet e kompjuterizuara kontabël. GVJ këshillon që në të ardhmen ky element të rishikohet nga Institucioni brenda kufizimeve ligjore përkatëse.</i></p>														
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk</b>      <b>Përmbushet</b>      <b>Përmbushet</b>      <b>Përmbushet</b></p>														

	përmbyshet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

<b>Standardi II.3</b>	
<b>Përmbajtja e lëndëve, moduleve dhe formave të tjera formuese të programeve të studimit me karakter profesional është në përputhje me objektivat formuese, rezultatet e të nxënit dhe kërkesat e tregut të punës për këto programe.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit përmban të dhëna të plota mbi përmbajtjen e moduleve/lëndëve të formimit teorik e praktik dhe aktivitetëve të tjera të formimit sipas strukturës e planit të studimit.</p>	<p>GVJ analizoi të dhënat në dokumentacionin e dorëzuar në DVV dhe konstatoi se në tërësinë e tyre ato paraqesin të dhëna të plota në lidhje me përmbajtjen e moduleve dhe lëndëve të programit të studimit. Informacionet e nevojshme u konstatua që ishin gjithashtu të publikuara në faqen e internetit të Institucionit.</p> <p><i>[Referenca: 7. Rregullore e programit të studimit DP Kontabilitet.pdf; <a href="https://uet.edu.al/neë/diploma-profesionale/">https://uet.edu.al/neë/diploma-profesionale/</a>; <a href="https://uet.edu.al/new/wp-content/uploads/2019/01/DP-Kontabilitet.pdf">https://uet.edu.al/new/wp-content/uploads/2019/01/DP-Kontabilitet.pdf</a>]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Përmbajtja e programit të studimit është aktuale, i plotëson kërkesat e veçanta të profesionit dhe kërkesat për aftësitë shprehite e kërkuara/të pritshme nga punëdhënësit.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Përmbajtja parashikon zhvillimin e aftësive të transferueshme, e shtrirë edhe në modulet e përmbajtjen e tyre, gjatë zhvillimit të kurrikulës dhe në metodat e mësimdhënies dhe vlerësimit.</p>	<p>Bazuar në përmbajtjen e lëndëve të programit të studimit, shpërndarjen e orëve mes lëndëve dhe raportin teori / praktikë, GVJ gjykon se programi i studimit “Diplomë Profesionale në Kontabilitet” është në përgjithësi i përputhshëm me tendencat aktuale të këtij profesioni në vend dhe në rajon. Programi plotëson kryesisht kërkesat e veçanta për dije në këtë profesion, si aftësi teknike në mbajtjen e kontabilitetit, njohuri për zhvillimin e tregjeve financiare, dije mbi klasifikimin dhe kalkulimin e kostove, aftësi për mbajtjen e kontabilitetit të informatizuar, njohuri mbi sistemin tatimor në vendin tonë, etj.</p> <p>Të pajisur me këto informacione studentët e diplomuar në këtë program mund të punojnë në pozicionet e synuara nga programi si asistent kontabilist, asistent financier, apo asistent auditues.</p> <p>Por meqënëse ka gjithmonë vend për përmirësim, <i>GVJ këshillon që programi të lehtësohet nga të paktën një lëndë e kategorisë së formimit të përgjithshëm e të pasurohet me lëndë më specifike për profesionin.</i></p> <p>Metodat e mësimdhënies dhe të vlerësimit që mbështeten ndjeshëm në angazhimin e studentëve duke i organizuar në grupe pune, garanton që dijet përfitohen dhe transferon mes</p>

	<p>anëtarëve të ekipeve të punës (shembulli i syllabusit në lëndën e Taksimit).</p> <p>[Referenca: 14.1. Plani mesimor i programit te studimit - DP Kontabilitet.pdf; 19. Syllabus Taksim.pdf]</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Modulet dhe aktivitetet e formimit teorik e praktik/punë konkrete mundësojnë përftimin e njohurive, aftësive dhe shkathtësive ndërkurrikulare, të menduarit kritik, zgjidhjen e problemeve në kontekste konkrete, komunikimin dhe marrëdhëniet me të tjerë, si dhe orientimin cilësor në përvojën e punës.</p>	<p>Raporti teori / praktikë i cili anonte dukshëm nga ky i fundit për programin e studimit “Diplomë Profesionale në Kontabilitet”, (shiko kriteri II.2.4 më lart) përbën një pikë avantazhuese të programit. Për më tepër, bazuar edhe në shqyrtimin e detajuar të përshkrimit të metodave të vlerësimit të studentëve në rregulloren e programit të studimit dhe në programet lëndore, GVJ konstaton se i kushtohet vëmendje e veçantë “vënies në punë” të studentëve në mënyrë që ata të ofrojnë zgjidhje për problematika të disiplinave të ndryshme.</p> <p>[Referenca: 7. Rregullore e programit te studimit DP Kontabilitet.pdf; 14.1. Plani mesimor i programit te studimit - DP Kontabilitet.pdf]</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit.</p>	<p>GVJ konstatoi nga dokumentacioni i DVV një numër të konsiderueshëm të marrëveshjeve të bashkëpunimit me Institucione partnere për të zhvilluar praktikën / internship-in. Nga ana tjetër, Rregullorja e Programit të Studimit si edhe Rregullorja e posacme për praktikën janë të detajuara dhe drejtpërdrejta në lidhje me kriteret që duhet të plotësohen nga Institucionet partnere që ofrojnë vende praktike dhe studentët që kryejnë këto praktika.</p> <p>Gjatë vizitës në Institucion GVJ kërkoi informacion të detajuar në lidhje me Institucionet konkrete ku studentët e programit kishin kryer praktika semestrin e dytë të vitit akademik 2020 – 2021, dhe u informua se praktika profesionale e parashikuar në këtë program studimi, zhvillohet në ambientet e UET në formën e leksioneve të specializuara me profesionistë të fushës së financës-kontabilitetit. Praktika profesionale ndiqet dhe mbikëqyret nga pedagogu përgjegjës i praktikës dhe drejtuesi i njësisë bazë.</p> <p><i>Lidhur me organizimin e praktikës profesionale <u>GVJ rekomandon</u> që institucioni të shfrytëzojë më mirë këto marrëveshje bashkëpunimi për të mundësuar organizimin e praktikave profesionale pranë bizneseve/institucioneve konkrete për një familjarizim sa më të mirë të studentëve të këtij programi studimi me ambientin real të punës.</i></p> <p>[Referenca: 32. Lista e subjekteve bashkepunuese.pdf; 12.5.</p>

	<i>Bashkepunime me biznesin - Projekti 500+.pdf; 32.1 Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale.pdf; vizita në institucion]</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional përmes politikave e udhëzimeve të posaçme dhe mbështetet në metodat dhe praktikat më të mira të fushës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues të posaçëm, ngre struktura të posaçme dhe zhvillon mekanizma të vlerësimit e të monitorimit të cilësisë së mësimdhënies dhe metodave të përdorura dhe aftësive të stafit të angazhuar, duke përfshirë aktivisht studentët në këtë proces. Rezultatet e këtyre vlerësimeve bëhen publike.	<p>Sipas RVB të paraqitur nga Institucioni për këtë kriter dhe nga cka konstaton mbështetur në dokumentacionin e DVV, GVJ konfirmon se Institucioni ka parashikuar procedura standarde dhe ka ngritur struktura specifike për monitorimin e cilësisë së mësimdhënies si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Vlerësimi i procesit mësimor, lëndëve dhe pedagogëve nga studentët;</li> <li>• Vlerësimi i pedagogëve nga kolegët dhe eprorët, kryesisht për pedagogët e rinj;</li> <li>• Vlerësimi dhe monitorimi i cilësisë së syllabuseve dhe i kurrikulave nga KSBC;</li> <li>• Zhvillimi i leksioneve të hapura;</li> <li>• Vetëvlerësimi dhe vlerësimi nga Komisioni i Vlerësimit të Performancës;</li> </ul> <p>Këto praktika të monitorimit të vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe metodave të përdorura e aftësive të stafit konfirmohen edhe nga personeli akademik gjatë intervistave të zhvilluara me ta në vizitën në Institucion.</p> <p><i>[Referenca: 8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë.pdf; 13. Dokumenti E.VIII Mbi funksionimin e Zyrës së Kurrikulave.pdf; 30.3. Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2017-2020.pdf; 30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë.pdf; 30.7. Shpërndarja e relacionit të KSBC mbi silabuset.pdf; 30.8. G-III-4-1 Formulari i vlerësimit</i></p>


	<p><i>te pedagogut nga eprori-kolegu.pdf; 41. G-I-12-1 Formular i vetevlerësimit te performancës së personelit akademik.pdf; 40.1. D-VI-3-3 Formular për ankesat e studentëve.pdf; 40. G-III-4-2 Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra e kursit/eseja, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni e që është e përshtatshme për realizimin e programit të studimit.</p>	<p>Analiza e programeve lëndore të programit të studimit “Diplomë Profesionale në Kontabilitet”, evidenton se format e parashikuara të mësimdhënies janë të larmishme dhe kombinojnë leksionet me seminare, orë ushtrimesh, detyra kursi dhe prezantime individuale dhe në grup të studentëve.</p> <p>Mënyra e realizimit të orëve të mësimi u konfirmua edhe me pedagogët e programit të studimit të cilët cilësuan se aplikimi i metodave të ndryshme të mësimdhënies ishte një prioritet i punës së tyre.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik përdor forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve.</p>	<p>Përdorimi i formave të larmishme të mësimdhënies është i parashikuar në rregulloren e programit të studimit si edhe në programet lëndore të veçanta. Shfrytëzimi i mjeteve si raste studimore, detyra kursi, prezantime individuale dhe punë në grup janë të gjitha të përshkruara në dokumentacionin e DVV dhe dëshmojnë përpjekjen institucionale për të garantuar larmi dhe diversitet mësimdhënie dhe vlerësimi për të përfshirë sa më shumë studentët sipas tipareve të personalitetit të tyre. Të pyetur gjatë vizitës në institucion, personeli akademik konfirmoi përpjekjet për të mbajtur të angazhuar dhe të interesuar studentët, sidomos gjatë sfidave të mësimi online. Shqyrtimi i CV të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi nga ana tjetër mbështet argumentin e aftësive dhe kompetencës së tyre në fushat respektive: kontabilitet / auditim / analizë. Staf i angazhuar karakterizohet nga një nivel angazhimi praktik i cili është në përputhje të plotë me profilin e programit të studimit. GVJ e konsideron plotësisht të përmbushur këtë kriter.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies, përfshirë ato interaktive e gjithëpërfshirëse, sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>[Referenca: 7. Rregullore e programit te studimit DP Kontabilitet.pdf; 14.1. Plani mesimor i programit te studimit - DP Kontabilitet.pdf; CV të stafit; vizita në institucion]</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të mbështesë stafin përmes njohjes me shembujt e praktikave të mira, të nxisë dhe të inkurajojë personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>GVJ gjatë analizës së dokumentacionit që është pjesë e DVV konstatoi disa dokumenta që dëshmojnë mbështetjen institucionale për personelin akademik në funksion të trajnimeve të tyre dhe ekspozimit ndaj praktikave më të mira që mund të adoptohen nga stafi. Në RVB janë listuar një sërë trajnimesh si aktiviteti Back</p>

	<p>to Work, Staff Development Day, etj, por edhe pjesëmarrje e personelit akademik në projekte kërkimore dhe shkencore të cilat edhe këto sjellin përfitime në rritjen e cilësisë së mësimdhënies. Pas një shqyrtimi të detajuar të këtyre referencave (psh, evidenca 43.1 në DVV), GVJ konstaton se ato përmbajnë të dhëna të vjetra, disa herë punime shkencore dhe artikuj që nga viti 2010, pavarësisht se titullohen aktiviteti shkencor për vitin 2019-2020. GVJ pyeti gjatë vizitës në Institucion se cilat ishin trajnimet më të fundit të ofruara për stafin akademik, dhe u informua se stafi ka vazhdimisht trajnime sidomos në vitin e parë të angazhimit të tij pranë Institucionit, si psh në lidhje me fusha si mësimdhënia, komunikimi, lidhshipi, madje të shoqëruara në disa raste edhe me provime në fund. Trajnimi i fundit i stafit është bërë për platformën online MS Teams në lidhje me çështje të pedagogjisë dhe aftësisë në mësimdhënie.</p> <p>[Referenca: 33. Trajnime profesionale.pdf; 43.3 Pjesemarrja ne projekte 2019-2020.pdf; 43.1 Te dhena per kerkimin shkencor 2019-2020.pdf; vizita në institucion]</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>


**Standardi III.2**

**Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike të nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor teorik e praktik, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>Bazuar në evidencën <i>Infrastruktura në funksion të zhvillimit të programit (Ref. Nr. 42) del në pah</i> se Institucioni garanton hapësira dhe infrastrukturë të mjaftueshme dhe të mirëmbajtur që mundësojnë kryerjen në mënyrë dinjitoze të procesit mësimor. Kampusi i UET ka tre godina me salla mësimore, bibliotekë dhe laboratorë mësimorë. Nga vizita në Institucion, GVJ konstatoi se në ambientet e Universitetit funksionon rrjeti wireless për studentët dhe se sallat mësimore ishin të pajisura me mjetet e duhura audio-vizuale që garantojnë një proces mësimor të kompletuar me të gjitha format e nevojshme të mësimdhënies.</p>



	<p>Megjithatë, Institucioni së shpejti pritet të zhvendoset në një lokacion tjetër për të cilin nuk disponohen të dhëna në DVV. Ky fakt u pohua për GVJ gjatë vizitës në Institucion.</p> <p><i>[Referenca: 0. RVB_DP Kontabilitet.pdf; 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor, si dhe sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>	<p>Studentët kanë akses në sistemin UET LMS i cili është me bazë Moodle dhe lehtëson procesin mësimor dhe ndërveprimin mes studentëve dhe pedagoëve. Në këtë sistem, studentët kanë akses individual nëpërmjet llogarive të dedikuara të tyre. Në ambientet e kampusit studentët mund të shfrytëzojnë programe të nevojshme në funksion të nevojave të përgjithshme të procesit mësimor si MS Teams, MS Office, Access, dhe programe të dedikuara për nevoja të mësimdhënies dhe mësimnxënies në fushën e kontabilitetit si Financa 5 / AlphaWeb etj.</p> <p><i>[Referenca: 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit.pdf; 46.3. UET LMS Guide per studentet.pdf; 46.4. Video-trajtime mbi sistemin TEAMSLMS.pdf; 46. Manuali i perdoruesit te sistemit UMIS.pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Për të analizuar shkallën e përmbushjes së këtij kriteri GVJ shqyrtoi me vëmendje disa dokumentacione, si listën e plotë të teksteve në dispozicion të studentëve të programit të studimit “Diplomë Profesionale në Kontabilitet” në bibliotekë, dhe më specifikisht titujt e literaturës bazë dhe asaj ndihmëse të specifikuar në programet lëndore dhe të përmbledhura në shtojcën 2 të rregullores së programit. Bazuar në titujt e përfshirë në literaturë dhe të vendosura në dispozicion të studentëve GVJ formon opinionin se fondi i njohurive në këta tituj u hap studentëve mundësinë e përfuturit të dijeve dhe njohurive të nevojshme në përputhje me syllabuset e lëndëve, objektivat e formimit dhe rezultatet e pritshme të të nxënies. Pavarësisht se shumica e literaturës i përket viteve të hershme (më larg se 5 vite), për arsye se nuk ka pasur botime më të fundit, GVJ gjykon se titujt e literaturës bazë janë të përshtatshëm për të garantuar mbarëvajtjen e suksesshme të programit të studimit.</p> <p><i>[Referenca: 7. Rregullore e programit te studimit DP Kontabilitet.pdf; 45. Inventari i tekseteve per fushen e programit te studimit.pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në funksion të mësimdhënies</p>	<p>Tabela 17 në shtojcat e RVB rendit libraritë on-line të cilat</p>






<p>dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>janë në dispozicion të programit të studimit “Diplomë Profesionale në Kontabilitet” si SAGE, Questia, EBSCO për afate mbi 5 vite deri pa limit.</p> <p>Gjatë vizitës në Institucion, GVJ intervistoi stafin akademik dhe studentët e programit në lidhje me shkallën e shfrytëzimit nga ana e tyre të bibliotekave online dhe konstatoi se jo vetëm studentët nuk e kishin shfrytëzuar bibliotekën online, por as stafi nuk karakterizohet nga një shkallë e lartë e përdorimit të tyre.</p> <p><i>Gjatë vizitës në Bibliotekë, GVJ konstatoi se aksesit në bibliotekat online ishte teknikisht jo i lehtë dhe këshillon lehtësim të aksesit për të nxitur rritjen e shkallës së përdorimit të tyre si nga stafi ashtu edhe nga studentët.</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Gjatë vizitës në Institucion GVJ mundi të verifikonte se sallat e UET janë të pajisura me PC dhe projektorë të cilat shfrytëzohen nga personeli akademik dhe studentët për prezantimin e detyrave të kursit gjatë orëve mësimore, apo detyrave të tjera sipas specifikave të procesit mësimor. Orët laboratorike në këtë program studimi lidhen me studimin e programit të kontabilitetit aplikativ Alpha Web.</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Gjatë vizitës në Institucion dhe në mbështetje të dokumentave të DVV, GVJ konstatoi se në funksion të mësimdhënies, personeli akademik i UET përdor platformën online UET LMS si edhe programe të cilat kanë ndihmuar në menaxhimin e mësimit online në semestrat e fundit (MS TEAMS) gjatë procesit mësimor online. Nëpërmjet këtyre sistemeve stafi akademik dhe studentët mund të komunikojnë në mënyrë të vazhdueshme për të përmbushur kërkesat e procesit mësimor.</p> <p><i>[Referenca: 46.2. UET LMS Guide per pedagogun.pdf; 46.3. UET LMS Guide per studentet.pdf; 46.4. Video-trajnime mbi sistemin TEAMSLMS.pdf; 46. Manuali i perdoruesit te sistemit UMIS.pdf; vizita në institucion]</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	


**Standardi III.3**

**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat garantojnë cilësinë e**




**mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit dhe rritjen e vetëdijes për përmirësimin e tyre.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që ndjekin, vlerësojnë dhe monitorojnë procesin e mësimdhënies dhe koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së saj.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit në DVV, <i>Statuti i UET, Nenet 11 &amp; 16</i>, GVJ konstaton se është parashikuar dhe rregulluar ngritja dhe funksionimi i një strukture për monitorimin vlerësimi dhe promovimin e përmirësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në Institucion. Kjo strukturë, njihet si Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, (në vijim) KSBC, dhe është një strukturë autonome, që propozet nga Rektori dhe miratohet nga Senati i Universiteti. Komisioni është pjesë e përhershme e strukturës organizative të universitetit që vlerëson periodikisht, rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore, si dhe propozon ndryshime për përmirësime të nevojshme, mbështetur në udhëzimet e sigurimit të cilësisë në hapësirën europiane të arsimit të lartë dhe legjislacionit në fuqi. KSBC bashkëpunon me fakultetet dhe departamentet për përmbushjen e detyrave dhe aktiviteteve të tij.</p> <p>[Referenca: 2. Statuti UET.pdf; 8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë.pdf]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për procesin e mësimdhënies, cilësinë e saj dhe rritjen e vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>GVJ, referuar dokumentacionit të DVV, dhe më konkretisht dokumentit "<i>Për organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit</i>", konstaton se njësia kryesore / departamenti i Ekonomiksit dhe Financës në këtë rast, është përgjegjës për programet e studimit që ofron (pika F.V.3.1), që nga përzgjedhja e personelit akademik që angazhohet në mësimdhënie e deri tek shpërndarja optimale e ngarkesës mësimore. Drejtuesi i Departamentit është përgjegjës për përmbajtjen e programit të studimit, dhe programeve të lëndëve nën kujdesin e Zyrës së Standardeve dhe Cilësisë, ai që miraton syllabuset e hartuara dhe bën vlerësimin e mësimdhënies. Stafi i departamentit dhe studentët janë në dijeni qysh në fillim të vitit akademik që do i nënshtrohen një procesi të vlerësimit të procesit mësimor.</p> <p>[Referenca: 6. Dokumenti F.IV-F.V Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit.pdf]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të</p>	<p>Nga informacionet e marra gjatë diskutimeve me personelin akademik të programit mësimor në vizitën në Institucion, GVJ formoi bindjen se stafi pedagogjik është i</p>



<p>studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja, në përputhje me natyrën dhe specifikën e programeve profesionale.</p>	<p>fokusuar në lëvrimin cilësor të përmbajtjes së programit të studimit. Ata mundohen të shfrytëzojnë maksimalisht mundësitë e ofruara nga Institucioni për përdorimin e metodave të reja të mësimdhënies, por siç edhe vetë Institucioni e deklaroi në RVB për këtë kriter, pedagogët më të rinj janë më elastikë dhe fleksibël për t'u përshtatur me këto metoda të reja. Gjithsesi duke gjykuar nga opinioni që formoi gjatë intervistave me personelin akademik dhe studentët e programit të studimit, GVJ gjykon që ky kriter përmbushet plotësisht.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies përmes trajnimeve të vazhdueshme të personelit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të tyre.</p>	<p>Nga diskutimet e kryera gjatë vizitës në Institucion, del në pah se drejtuesit e UET kanë një frymë që nxit zbatimin dhe përfshirjen e risive dhe metodave të reja inovative të mësimdhënies që jaanë në funksion të përmbushjes së objektivave të të nxënit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në DVV si edhe nga diskutimet me personelin akademik, GVJ konstatoi se UET kryen vazhdimisht trajnime të personelit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies. Natyrshëm, fokusi kryesor i këtyre trajnimeve gjatë muajve të fundit ka qenë në drejtimin e facilitimit të mësimdhënies online nëpërmjet platformave si Teams, LMS, etj. Të pyetur për trajnimet e kryera, stafi akademik konfirmon përjasjen e Institucionit drejt nxitjes së trajnimeve të vazhdueshme dhe përmendi disa trajnime specifike si psh në fushën e aftësive pedagogjike.</p> <p><i>[Referenca: 46.4. Video-trajnime mbi sistemin TEAMS LMS.pdf; 46.2. UET LMS Guide per pedagogun.pdf; 43.4 Trajnim mbi sistemin UET LMS.pdf; 33. Trajnime profesionale.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Sipas diskutimeve me anëtarë të personelit akademik gjatë vizitës në Institucion, në UET personeli akademik është i mirëpritur të testojë metoda të reja në mësimdhënie dhe nëse shohin efekte pozitive prej këtyre eksperiencave janë të nxitur që t'i ndajnë dhe diskutojnë edhe me kolegët e tjerë gjatë mbledhjeve të departamentit. Nëse një eksperiencë e re, shihet si pozitive, ajo është e mundur të përfshihet edhe formalisht në programin lëndor pasi këto të fundit rishikohen në mënyrë periodike çdo vit. Gjatë diskutimeve të GVJ me stafin pedagogjik këta të fundit sollën një sërë shembujsh sesi përpiqen të integrojnë metoda të reja në mësimdhënie për të mundur një proces mësimor sa më efektiv.</p> <p><i>[Referenca: 41. G-I-12-1 Formular i vetevlerësimit te</i></p>



	<i>performancës së personelit akademik.pdf; vizita në institucion]</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi III.4</b>	
<b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme për vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën për çdo student.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, të cilat bëhen publike. Institucioni mban dhe ruan dokumentacionin e vlerësimeve, ankimimet dhe rishqyrtimet e vlerësimit, sipas afateve e procedurave në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit në DVV, GVJ formoi opinion se për programin e studimit “Diplomë Profesionale në Kontabilitet” janë përcaktuar me detaje në dokumenta rregullatore (referenca më poshtë), mënyra e vlerësimit të dijeve për studentët e programit. Këto bëhen publike dhe me dije studentëve jo vetëm duke u vënë në dispozicion dokumentacionin përkatës, por edhe duke prezantuar programet lëndore në fillim të çdo semestri. Sipas konfirmimeve nga biseda me studentët, ata ishin të qartë për mënyrën e vlerësimit të dijeve dhe aftësive në profesion dhe kishin mundësi të ankimimit të rezultateve para hedhjes finale të tyre në sistem.</p> <p><i>[Referenca: 7. Rregullore e programit te studimit DP Kontabilitet.pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Nga shqyrtimi i rregullores së programit të studimit “Diplomë Profesionale në Kontabilitet” dhe programeve lëndore, GVJ konstaton se në to jepen informacione në lidhje më mënyrat e ndryshme të vlerësimit të studentëve. Vlerësimi sipas tipologjisë së lëndës është paraqitur edhe në tabelën 15 në shtojcat e RVB.</p> <p><b><i>Për lëndët e Tipologjisë I</i></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Provimit përfundimtar (40%)</li> <li>▪ Detyrave praktike: 2 (dy) x 30% = (60%)</li> </ul> <p><b><i>Për lëndët e Tipologjisë II</i></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Provimit përfundimtar (40%)</li> <li>▪ Provimit të ndërmjetëm (30%)</li> <li>▪ Detyrë kursi (20%)</li> <li>▪ Nivelit të diskutimit në seminare (10%)</li> </ul> <p>Larmia e trajtave të vlerësimit dhe shpërndarja e pikëve mes këtyre formave të ndryshme u jep mundësinë studentëve që të shprehin njohuritë e tyre dhe kompetencat</p>

	<p>e fituara në një larmi formash, pa diskriminuar aftësi të veçanta të të mësuarit apo transmetimit të dijeve të ndonjë prej studentëve.</p> <p>[Referenca: 7. Rregullore e programit të studimit DP Kontabilitet.pdf]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli, studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës /modulit.</p>	<p>Bisedat e kryera me studentët e programit të studimit “Diplomë Profesionale në Kontabilitet” gjatë vizitës në Institucion, konfirmojnë atë që tashmë shprehet edhe në RVB se studentët njihen me të gjitha elementet e nevojshme të programit lëndor në seancën e parë të semestrit. Gjatë kësaj seance të parë mësimore, pedagogët bëjnë një prezantim të detajuar të temave që do të zhvillohen, metodologjisë dhe qasjes së lëndës, literaturës dhe vlerësimit të pritur së bashku me afatet e parashikuara për çdo mënyrë vlerësimi. Në vijim elementet e nevojshme për ecurinë e lëndës (syllabusi, materialet mësimore, etj,) postohen në sistemin elektronik LMS dhe mund të aksesohen në çdo kohë nga studentët (rregullorja e programit të studimit, pika 3.1.8).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik, duke venë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat garantojnë anonimat, eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Komponentët e vlerësimit të studentëve (të paraqitur më lart në kriterin 2 të këtij standardi) janë të shpërndarë për gjatë gjithë vitit akademik (në varësi edhe të tipologjisë së lëndës), dhe mundësojnë vlerësimin e njohurive në pika të ndryshme kontrolli përgjatë ecurisë së vitit.</p> <p>Institucioni në RVB të përgatitur për këtë kriter shprehet se ka një marrëveshje bashkëpunimi me AADF (Albanian-American Development Foundation) sipas së cilës po përdorin prej disa kohësh metodën e vlerësimit elektronik “<i>clean score</i>”. Ky sistem është aplikuar në lëndë të ndryshme si në nivelin bachelor dhe master, por edhe në programin e studimit Diplomë Profesionale në Kontabilitet sic konfirmojnë për anëtarët e GVJ, pedagogë të angazhuar në këtë program. Si rregull, Institucioni aplikon forma vlerësimi anonime duke pajisur studentët me një barkod unik të gjeneruar për çdo provim (<i>rregullorja e programit të studimit, pika 5.3.2</i>). Por në kushtet e pandemisë dhe mësimit online, testimet janë kryer nëpërmjet platformave elektronike në të cilat është (për momentin) e pamundur të garantohet anonimat i studentëve. Megjithatë, kontrolli i njohurive dhe vlerësimi i studentëve nëpërmjet platformave online nga ana tjetër përmirëson transparencën e procesit të vlerësimit për shkak të mundësisë për verifikim dhe arkivim konsistent të</p>

	të dhënave.			
<b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisione provimi, shoqërohet me komente e këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Sipas RVB të paraqitur nga Institucioni për këtë kriter, GVJ konstaton se vlerësimi me komision është i detyrueshëm vetëm për detyrimet si praktika profesionale dhe punimi i diplomës / provimi i përgjithshëm përfundimtar. Në rastin e lëndëve të programit, është në gjykimin e titullarit nëse korrigjimin do e bëjë i vetëm, apo në bashkëpunim me pedagogët asistentë. Vetëm në rastin e ankimimeve, Përgjegjësi i Departamentit ngre një komision me 3 anëtarë, i cili bën shqyrtimin e kërkesës dhe merr vendim me shumicë të thjeshtë. Në çdo rast vlerësimi i studentëve shoqërohet me komente për përmirësimin e tij në të ardhmen, dhe kjo u konfirmua nga stafi akademik dhe nga vetë studentët gjatë intervistave me ta.			
<b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse, duke garantuar njëkohësisht të drejtat e studentëve, për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me këto rregullore.	Sipas Rregullores së programit të studimit, (pika 5.3.4) provimet duhet të vlerësohen brenda një periudhe dy javore gjatë të cilës parashikohet të bëhen disa hapa si: procedura e afishimit paraprak të rezultateve, realizimi i seancave sqaruese me studentët gjatë të cilave këta të fundit kanë të drejtë të njihen me vlerësimin e detajuar të tyre dhe komentet e bëra në lidhje me përgjigjet që ata kanë dhënë dhe së fundmi dorëzimi i procesverbaleve në Sekretarinë Mësimore. Studentët njihen me vlerësimet përmes sistemit online LMS ku janë të detajuara të gjithë komponentët e vlerësimit të detajuar të tyre. Në rastin e riprovimeve, afati deri në përfundim të procesit është vetëm 1 javë për shkak të numrit më të ulët të studentëve. Gjatë vizitës në Institucion një praktikë e tillë u konfirmua si nga stafi akademik, ashtu edhe nga studentët.  [Referenca: 7. Rregullore e programit të studimit DP Kontabilitet.pdf]			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X


### Standardi III.5

**Zhvillimi i programit të studimit, deri në diplomim, garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët duke dhënë njëkohësisht njohuri të aplikuara dhe kompetenca profesionale lehtësisht të përdorshme në tregun e punës, apo për studime të mëtejshme.**

**Kriteret**

**Vlerësimi**

<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë përftimin e njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve, që janë në përputhje me rezultatet e pritura të të nxënit për programet me karakter profesional.</p>	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit të DVV por më shumë mbështetur në përshtypjet e krijuara nga informacionet e marra gjatë vizitës në Institucion, GVJ formoi opinionin se programi i studimit Diplomë Profesional në Kontabilitet është organizuar dhe përcohet në mënyrë të tillë që u mundëson studentëve të fitojnë njohuri specifike për profesionin. Ata marrin dije mbi kontabilitetin, financën dhe lëndë të lidhura me to si edhe praktikohen në elemente të nevojshme të punës së përditshme të profesionistëve të kontabilitetit që kërkon tregu i punës në Shqipëri (taksimi, sistemet e informacionit në kontabilitet). Për sugjerime për përmirësimin e përmbajtjes së programit, GVJ është shprehur më lart në këtë raport.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton njohuritë e përshtatshme dhe zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit, duke mbështetur diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave apo çështjeve të caktuara.</p>	<p>Nga shqyrtimi i Planit Mësimor dhe i përmbajtjes së dosjeve të syllabuseve (evidencat në DVV) të Programit të Studimit Diplomë Profesionale në Kontabilitet, GVJ konstatoi se ka mjaftueshëm elemente të teknologjisë së informacionit (lëndët: Baza të Informatikës dhe Sisteme të Kompjuterizuara Kontabël), dhe fushave humane e sociale (lënda Hyrje në Menaxhimin e Burimeve njerëzore apo Hyrje në Menaxhimin e Projekteve). Përveç lëndëve të dedikuara në këto aspekte, vetë organizimi i orëve mësimore konstatojmë se është i bazuar në ndërveprim dhe komunikim mes studentëve dhe pedagogëve por edhe mes studentëve me njëri tjetrin. Shpesh herë ata vendoseshin në situata konkrete ku prej tyre kërkohet të jepeshin alternativa të ndryshme zgjidhjeje të problemeve.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale, duke garantuar realizimin në praktikë të marrëveshjeve me punëdhënësit e aktorët e biznesit në përfitim të formimit praktik të studentëve. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar formimin cilësor dhe për të nxitur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Qëllimi dhe fusha e programit të studimit “Diplomë Profesionale në Kontabilitet” është aftësimi i studentëve për punë praktike në kontabilitet dhe fusha të lidhura direkt me të. Për këtë arsye programi është konceptuar duke i dhënë një rëndësi të konsiderueshme peshës së komponentëve praktikë siç edhe u argumentua nga GVJ më lart në këtë raport. Në funksion të praktikës, Institucioni ka një gamë të gjerë të marrëveshjeve të bashkëpunimit të cilat përfshijnë studentët e këtij programi dhe në funksion të të cilëve realizojnë praktikën në formën e “profesionit të sjellë në shkollë”. Të pyetur konkretisht për kompetencat profesionale të tyre, studentët u shprehën se nuk mendonin se do të hasnin vështirësi të theksuara në integrimin e tyre në</p>



	<p>praktikë, e megjithatë u shprehën se do preferonin të bënin edhe disa kurse shtesë para se të hynin në profesion.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo moduli apo lënde, personeli akademik vlerëson, analizon e shqyrton kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, duke nxjerrë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orientojnë studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Në RVB për këtë kriter Institucioni referon se në UET ekziston praktika që gjatë javës së fundit të mësimit pedagogu mbulon edhe njëherë çështjet më të rëndësishme dhe jep orientimet se ku duhet të fokusohen studentët për përgatitjen e tyre në provim. Gjithashtu pedagogu është në dispozicion të studentëve për konsulta përpara provimit edhe gjatë orëve të takimit zyrtar, sipas grafikut të shpallur në fillim të semestrit. Kjo praktikë mbështetet në kërkesat e rregullores së programit të studimit dhe u konfirmua edhe nga stafi akademik gjatë bisedave me ta.</p> <p><i>[Referenca: 7. Rregullore e programit të studimit DP Kontabilitet.pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni harton procedura të posaçme, të njohura e publike për diplomimin e studentëve dhe garanton mbështetjen dhe udhëzimin e studentëve në procesin e diplomimit. Ai mban regjistra zyrtarë të studentëve të diplomuar dhe i përditëson ata në fund të çdo viti akademik.</p>	<p>Referuar evidencës 10, GVJ konstaton se Institucioni ka hartuar procedura të detajuara për diplomimin e studentëve të Programit të Studimit “Diplomë Profesionale në Kontabilitet”. Edhe rregullorja e programit të studimit përshkruan me detaje procedurën e diplomimit (pika 8). Diplomimi i studentëve në këtë program studimi bëhet me përgatitjen dhe mbrojtjen e një Projekti Profesional me karakter aplikativ / praktik ose nëpërmjet Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar i cili zhvillohet si rast studimor i lidhur me lëndët karakterizuese të programit. Studentët që kanë të drejtë të përgatisin Projektin Profesional janë ata me mesatare në hyrje mbi 7.5. Kalendarit akademik parashikon 4 sezone për mbrojtjen e diplomës ose provimit gjatë vitit akademik. Studenti ka të drejtë të hyjë 2 herë në mbrojtjen e projektit profesional dhe nëse rezulton mbetës duhet të ndryshojë temën e projektit ose t’i nënshtrohet provimit të përgjithshëm përfundimtar. Gjatë vizitës në Institucion, pritej të dilte brezi i dytë i të diplomuarve për këtë program studimi (në vitin akademik të mëparshëm 2019 – 2020 kishte vetëm dy të diplomuar).</p> <p><i>[Referenca: 7. Rregullore e programit të studimit DP Kontabilitet.pdf; 10. Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësia përgjegjëse, personeli akademik dhe udhëheqësit akademikë</p>	<p>Sipas Rregullores së Programit të Studimit pedagogët</p>




<p>orientojnë dhe ndihmojnë studentët për përgatitjen e punimit të diplomës, realizimin e veprimtarisë praktike dhe përpunimit të rezultateve, duke garantuar bashkëpunimin edhe me aktorë të jashtëm për realizimin e saj.</p>	<p>udhëheqës duhet të zhvillojnë seanca metodologjike për udhëheqjen e studentëve që do përgatisin projektin profesional, sipas një kalendari takimesh të shpallura. Projekti profesional duhet të përmbushë kriteret për paraqitjen, kriteret që specifikohen qartë për studentët në dokumentin B.II. Edhe për studentët që do t'i nënshtrohen provimit të përgjithshëm përfundimtar organizohen gjithashtu seanca të posaçme konsultimesh.</p> <p>GVJ gjatë intervistave me studentët e programit të studimit “Diplomë Profesionale në Kontabilitet“, ata u shprehën se kishin nisur të punojnë për përgatitjen e temave të tyre.</p> <p><i>[Referenca: 7. Rregullore e programit të studimit DP Kontabilitet.pdf; 10. Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit.pdf; vizita në institucion]</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

#### IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE

<p><b>Standardi IV.1</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për përzgjedhjen dhe cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive nga ana e tyre</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura dhe kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura, që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të tij.</p>	<p>Bazuar në informacionet e dosjes së vetëvlerësimit (RVB), të faqes web të Universitetit European të Tiranës (UET), si dhe takimet e realizuara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se procedurat e rekrutimit të personelit akademik janë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe statutin e UET. Në faqen zyrtare web të UET dhe në media publikohen kriteret e përgjithshme dhe specifike të rekrutimit për çdo vend pune, të cilat janë në përputhje me specifikat e programit të studimit.</p>



GVJ konstatoi se kriteret e punësimit të personelit akademik përcaktohen nga njësia bazë dhe miratohen nga Dekanati i Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit. Në “Rregulloren për burimet njerëzore” përcaktohet qartë procedura që ndiqet në rekrutimin e personelit akademik, kriteret kryesore mbi të cilat mbështetet vlerësimi i kandidatëve në konkurim, si dhe përbërja e Komisionit të Rekrutimit. Në çdo rast, i gjithë procesi i rekrutimit ndiqet nga Zyra e Burimeve Njerëzore.

Referuar dokumentit (*Aneks 0.2. Tabelat mbështetëse - DP Kontb, tabelat 6.1, 6.2, dhe 6.3*), të dhënat për stafin e angazhuar në mësimdhënie për këtë program studimi për gjatë tre viteve akademike paraqiten si vijon:

Për vitin akademik **2020-2021** janë të angazhuar **21** pedagogë gjithsej, ndër të cilët **20 PAE**, nga ku 7 me tituj/grada dhe **1 PAK** me Msc.

Mbulimi i programit në përqindje për këtë vit akademik është **95% nga PAE** dhe **5% nga PAK**.

Për vitin akademik **2019-2020** janë të angazhuar **26** pedagogë gjithsej, ndër të cilët **23 PAE**, nga ku 11 me tituj/grada dhe **3 PAK**, 2 me tituj/grada.

Mbulimi i programit në përqindje për këtë vit akademik është **88% nga PAE** dhe **12% nga PAK**.


Për vitin akademik **2018-2019** janë të angazhuar **13** pedagogë gjithsej, ndër të cilët **12 PAE**, nga ku 6 me tituj/grada dhe **1 PAK** me Msc.

Mbulimi i programit në përqindje për këtë vit akademik është **92% nga PAE** dhe **8% nga PAK**.

GVJ konstatoi se pranë UET pozicionet kryesore administrative mbulohen nga personel i angazhuar edhe në mësimdhënie, duke reflektuar ngarkesën mësimore në përputhje me funksionin. Aktualisht pranë departamentit përgjegjës për programin e studimit, departamenti i Ekonomiksit dhe Financës personeli akademik mbulon edhe detyra me karakter ndihmës akademik dhe ka vetëm një personel administrativ – Koordinatorin e departamentit.

*GVJ gjykon se mbivendosja e detyrave akademike dhe administrative, karakteristikë për UET, shton ngarkesën e personelit akademik, rrit mundësinë e konfliktit të interesit gjatë procesit të realizimit të secilës kategori të detyrave dhe mund të influencojë cilësinë e realizimit të tyre prandaj*


	<p><i>këshillon rishikimin e kësaj praktike nga ana e institucionit.</i></p> <p><i>[Referenca: 0. RVB_DP Kontabilitet.pdf; 2. Statuti UET.pdf; 11.Dokumenti G. Rregullore për burimet njerëzore.pdf; 11.1 Shembull thirrje për staf akademik.pdf; 0.2. Aneks - Tabelat mbeshketese - DP Kontb.pdf; <a href="https://uet.edu.al/new/sq/punesimi-ne-uet">https://uet.edu.al/new/sq/punesimi-ne-uet</a>; vizita në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program, personin përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, përfshirë tutorët apo vëzhguesit e praktikës në institucionet partnere, si dhe atë të personelit ndihmësmësimitor-shkencor dhe administrativ të angazhuar.</p>	<p>Bazuar në informacionin e RVB, si dhe në informacionin e siguruar nga vizita në institucion, GVJ konstatoi se UET mban të dhëna të përditësuara për të gjithë personelin e angazhuar në programin e studimit Diplomë Profesionale në “Kontabilitet”. Zyra e Burimeve Njerëzore është struktura përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të angazhuar në programin e studimit, në formatin e dosjeve personale. Nga verifikimi me zgjedhje i dy dosjeve të personelit akademik të përfshirë në program (një me kohë të plotë dhe një me kohë të pjesshme), GVJ konstatoi plotësinë e tyre në përputhje me formatin e miratuar.</p> <p><i>[Referenca: 0. RVB_DP Kontabilitet.pdf; 2. Statuti UET.pdf; 11.Dokumenti G. Rregullore për burimet njerëzore.pdf; 44.1. Format dosje staf akademik me kohë të plotë.pdf; 44.2. Format dosje staf akademik me kohë të pjesshme.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit me karakter profesional dhe për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Bazuar në informacionin e dosjes së vetëvlerësimit si dhe takimet e realizuara gjatë vizitës në UET, GVJ konstatoi se institucioni është i angazhuar në krijimin e një mjedisi të përshtatshëm pune dhe me mundësi të barabarta për të gjithë personelin e angazhuar në programin e studimit “Diplomë Profesionale në Kontabilitet”.</p> <p>Aktualisht pranë departamentit të Ekonomiksit dhe Financës, departamenti përgjegjës për programin e studimit, personeli akademik mbulon edhe detyrat me karakter ndihmës akademik dhe ka vetëm një personel administrativ – Koordinatorin e departamentit.</p> <p>Mjediset aktuale në të cilat zhvillohen aktivitetet mësimore, kërkimore dhe administrative, edhe pse jo të dedikuara sipas programeve të studimit, rezultuan të pajisura me infrastrukturën dhe teknologjinë e nevojshme për një realizim sa më profesional dhe eficient të detyrave nga personeli i angazhuar në këtë program studimi.</p> <p>Megjithatë në takimet e realizuara gjatë vizitës në institucion, GVJ u informua për zhvendosjen e aktivitetit të</p>



	<p>UET në ambiente të reja për vitin akademik 2021-2022, për të cilat nuk patëm mundësi të merrnim informacion përtej një përshkrimi të përgjithshëm.</p> <p>[Referenca: 0. RVB_DP Kontabilitet.pdf; 2. Statuti UET.pdf; 11.Dokumenti G. Rregullore për burimet njerëzore.pdf; 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit.pdf; vizita në institucion]</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit, përmes organizimit të programeve specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, si dhe mbështetjen për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Programi i studimit “Diplomë Profesionale në Kontabilitet” administrohet nga Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës, i Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit të UET. Me synimin e një organizimi sa me efikas dhe sa më eficient të mësimdhënies dhe punës kërkimore, stafi akademik i këtij departamenti është i organizuar në dy grupe mësimore kërkimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Grupi mësimor Ekonomiks &amp; Financë;</li> <li>▪ Grupi mësimor i Kontabilitetit;</li> </ul> <p>Në takimin me stafin akademik të programit të studimit, GVJ konstatoi angazhimin dhe mbështetjen e UET për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik nëpërmjet organizimit të seminarit të përvitshëm “Back to Work”, të trajnimeve dhe webinar-eve për mësimdhënien, përfshirjes në projekte bashkëpunimi dhe shkëmbimi me institucione partnere ndërkombëtare dhe kombëtare, si edhe të financimit të kërkimit shkencor për stafin që boton artikuj në revista shkencore të indeksuara në Thomson Reuters/Scopus. Vëmendja e UET për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit shprehet qartë edhe në objektivat dhe prioritetet e vendosura në planin strategjik të zhvillimit të UET për periudhën 2021-2025.</p> <p>[Referenca: 2. Statuti UET.pdf; 3.3 PLANI STRATEGJIK_UET_2021.pdf; 11.Dokumenti G. Rregullore për burimet njerëzore.pdf; 33. Trajnime profesionale.pdf; 43.4 Trajnim mbi sistemin UET LMS.pdf; vizita në institucion]</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

**Standardi IV.2**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e**



**përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të përshtatshëm sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit me karakter profesional**

Kriteret	Vlerësimi
----------	-----------

**Kriteri 1.** Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.

**Kriteri 2.** Mjediset mësimore, si: klasat, laboratorët, studiot e mjediset e tjera janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.

Bazuar në informacionin e dosjes së vetëvlerësimit si dhe gjatë vizitës në UET, GVJ konstatoi se mjediset aktuale të institucionit janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e të gjitha aktiviteteve mësimore, kërkimore dhe administrative, të pajisura me infrastrukturën dhe teknologjinë e nevojshme për një realizim sa më profesional dhe eficient të detyrave nga personeli i angazhuar në këtë program studimi. Të dhënat në vijim i referohen të gjitha mjedisëve aktuale në dispozicion të studentëve dhe personelit pranë UET:


Mjedisi	Nr. Sallash
Salla leksioni	10
Salla seminari	14
Laborator informatike	4
Bibliotekë	1
Ambiente ndihmëse (fotokopje/zyra info/ të tjera ndihmëse)	6

Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se mjediset aktuale mësimore në të dy godinat A & B të UET, janë të pajisura me pajisje të teknologjisë së informacionit që garantojnë lidhjen me internet sipas nevojave të përdoruesve si dhe sallat e leksionit janë të pajisura me videoprojektorë dhe tabela bashkëkohore. Në takimet me stafin akademik dhe studentët e këtij programi studimi, gjatë vizitës në institucion, GVJ konfirmoi se mësimi zakonisht zhvillohej gjatë ditëve të javës, në të dy godinat e UET, në intervalin orar 8.30-14.30 por gjatë gjithë vitit akademik 2020-2021 dhe pjesërisht gjatë 2019-2020, për shkak të pandemisë mësimi është zhvilluar online.

*Megjithatë në takimet e realizuara gjatë vizitës në institucion, GVJ u informua për zhvendosjen e aktivitetit të UET në ambiente të reja për vitin akademik 2021-2022, për të cilat nuk patëm mundësi të merrnim informacion përtej një përshkrimi të përgjithshëm.*

*[Referenca: 0. RVB\_DP Kontabilitet.pdf; 2. Statuti UET.pdf; 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit.pdf; vizita në institucion]*

<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas fushës specifike të programit profesional, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Programi i studimit “Diplomë Profesionale në Kontabilitet” nuk ka kërkesa specifike për laboratorë të dedikuar, por në dispozicion të studentëve të UET janë katër laboratorë informatike të cilat shfrytëzohen sipas nevojave. Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, listës së marrëveshjeve dhe memorandumëve të bashkëpunimit, si dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në UET, GVJ konstatoi se institucioni garanton zhvillimin e praktikave profesionale në përputhje me kërkesat e parashikuara në programin e studimit “Diplomë Profesionale në Kontabilitet”. Aktualisht praktika profesionale e parashikuar në këtë program studimi, zhvillohet në ambientet e UET në formën e leksioneve të specializuara me profesionistë të fushës së financës-kontabilitetit. Praktika profesionale ndiqet dhe mbikëqyret nga pedagogu përgjegjës i praktikës dhe drejtuesi i njësisë bazë.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ëve të studimit që ofron.</p>	<p><i>Siç u theksua edhe më sipër për vitin akademik 2021-2022, institucioni do të zhvendosë aktivitetin në ambiente të reja për të cilat nuk patëm mundësi të merrnim informacion përtej një përshkrimi të përgjithshëm. GVJ gjykon se në këto kushte dhënia dhënia e një vlerësimi objektiv për këtë kriter është e pamundur. Vlerësimi në vijim i referohet ambienteve aktuale, për të cilat jepet informacion edhe në RVB e përgatitur nga institucioni.</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale, internship-it dhe veprimtarive të tjera praktike thelbësore për programet me karakter profesional.</p>	<p><i>Lidhur me organizimin e praktikës profesionale GVJ rekomandon që institucioni të shfrytëzojë më mirë marrëveshjet e bashkëpunimit për të mundësuar organizimin e praktikave profesionale pranë bizneseve/institucioneve konkrete për një familjarizim sa më të mirë të studentëve të këtij programi studimi me ambientin real të punës.</i></p> <p><i>[Referenca: 0. RVB_DP Kontabilitet.pdf; 7. Rregullore e programit të studimit DP Kontabilitet.pdf; 34. Marrëveshje bashkëpunimi UET.pdf; 34.7 Memorandum Bashkëpunimi mes UET dhe WE WEB.pdf; 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit.pdf; vizita në institucion]</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X




**Standardi IV.3**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse e të posaçme të mësimnxënies, bibliotekën e literaturën dhe mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit dhe realizimin cilësor të tij**


<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit dhe krijon kushte për akses të barabartë e pa pagesë dhe të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe informacionin e marrë gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se UET vë në dispozicion të gjithë studentëve dhe stafit të tij, bibliotekën e universitetit në godinën C.</p> <p>Biblioteka, në ambientet aktuale të UET mund të shfrytëzohet pa pagesë, nga të gjithë studentët dhe personeli i UET kundrejt regjistrimit me kartelë anëtarësimi.</p> <p>Nga vizita në këtë bibliotekë rezultoi se biblioteka disponon literaturë fizike të nevojshme në mbështetje të këtij programi studimi dhe të programeve të tjera të UET si: tekste mësimore bazë dhe materiale ndihmëse në gjuhën shqipe; tekste mësimore dhe materiale ndihmëse në gjuhë të huaj; libra, periodikë dhe botime të institucioneve të tjera.</p> <p><i>[Referenca: 0. RVB_DP Kontabilitet.pdf; 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit.pdf; 45. Inventari i teksteve per fushen e programit te studimit.pdf; 45.1. Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë mësimore bazë, ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, të mjaftueshme dhe të përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e dosjes së vetëvlerësimit si dhe takimet e realizuara gjatë vizitës në UET, GVJ konstatoi se institucioni është i angazhuar në shtimin dhe përditësimin e fondit të bibliotekës dhe i ka përfshirë këto objektiva në prioritetet e zhvillimit strategjik afatgjatë.</p> <p>Gjithashtu, institucioni u mundëson akses të barabartë dhe të lirë në disa biblioteka online si SAGE, Questia, EBSCO. Ambienti aktual i bibliotekës ishte i pajisur me kompjutera, që mund të shfrytëzohen nga studentët dhe pedagogët në aktivitetet mësimore dhe kërkimore.</p> <p>GVJ konstatoi se oraret e shërbimit të bibliotekës (nga e hëna-të premtë në orarin 09:00-20:00 dhe të shtunë në orarin 10:00-17:00) janë në përputhje me nevojat e studentëve të këtij programi studimi por edhe të studentëve të tjerë të UET.</p> <p><i>Megjithatë, në takimet e realizuara gjatë vizitës në UET, GVJ konstatoi se shfrytëzimi i bibliotekës online nga studentët e këtij program studimi dhe stafi akademik ishte relativisht i kufizuar prandaj këshillon lehtësimin e aksesit në të, për të nxitur rritjen e shkallës së përdorimit të bibliotekës online si nga stafi ashtu edhe nga studentët.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit dhe duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	

	<p>[Referenca: 3.3. Plani Strategjik UET 2021.pdf; 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit.pdf; 45.1. Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës.pdf; <a href="https://uet.edu.al/new/sq/biblioteka; vizita në institucion">https://uet.edu.al/new/sq/biblioteka; vizita në institucion</a>]</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, përmes bashkëpunimit me aktorë të jashtëm, të angazhuar në realizimin e programit mësimor, duhet t’u lehtësojnë dhe garantojë studentëve mbështetjen dhe përdorimin e burimeve e logjistikës së nevojshme të institucioneve partnere, në varësi të natyrës së angazhimit të tyre në procesin formues teorik, praktik dhe profesional të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit “Diplomë Profesionale në Kontabilitet”, në strukturën aktuale nuk ka kërkesa specifike për logjistikë të dedikuar në procesin e formimit teorik dhe profesional përveç programeve të kompjuterizuara të mbajtjes të kontabilitetit. Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në UET, GVJ konstatoi se marrëveshja aktuale e bashkëpunimit me zyrën e Kontabilitetit AKH u mundëson studentëve përdorimin e programit AlphaWeb.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni parashikon koston financiare të programit të studimit profesional, mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi dhe raportin financiar të përvitshëm dhe në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në UET, GVJ konstatoi se institucioni nuk harton raporte financiare të kostove sipas programeve të studimit por raporte vetëm në nivel universiteti dhe për periudha vjetore që përkohet me vitin financiar, i cili fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Raportet financiare përbëhen nga pasqyrat financiare vjetore të UET sëbashku me shënimet shpjeguese, një kopje e inventarëve gjendje në fund të vitit financiar dhe raporti i audituesit ligjor.</p> <p>Për vitin akademik 2018-2019 kosto mesatare rezultonte 191’790 lekë për student, tregues i llogaritur si një mesatare e thjeshtë në nivel universiteti e raportit të shpenzimeve faktike kundrejt numrit total të studentëve të regjistruar.</p> <p>Sipas Statutit të UET, projektbuxheti vjetor hartohet nga Administratori i institucionit dhe Zyra e Financës, në përputhje me propozimet e bëra në nivel fakulteti dhe në nivel departamenti ndërsa Bordi i Administrimit i UET garanton qendrueshmërinë financiare dhe përmbushjen e misionit të institucionit duke monitoruar zbatimin e planit financiar.</p> <p>Në planin strategjik të UET, për periudhën 2021-2025 theksohet angazhimi për menaxhim efektiv të burimeve të financimit dhe diversifikim të tyre; synohet për të investuar në teknologjitë e reja për kushte sa më bashkëkohore në kërkim &amp; mësimdhënie; synohet që gjysma e të ardhurave të shpenzohen për stafin dhe zhvillimin e tij, si dhe rritja e transparencës mbi gjendjen financiare të institucionit etj.</p> <p><i>Megjithatë GVJ nuk konstatoi ndonjë raport apo analizë sasiore lidhur me ecurinë financiare (të shkuar apo parashikim të ardhshëm) të programit të studimit apo të programeve të tjera prandaj rekomandon realizimin e një analize të tillë nga ana e institucionit si një instrument i nevojshëm për mbarëvajtjen e një</i></p>





	<p><i>programi studimi.</i></p> <p>[Referenca: 0. RVB_DP Kontabilitet.pdf; 2. Statuti UET.pdf; 0.2. Aneks - Tabelat mbeshetese - DP Kontb.pdf; 2.1-2.3 Pasqyrat Financiare 2018-2020 me shenime.pdf; 3.3. Plani Strategjik UET 2021.pdf; vizita në institucion]</p>																				
<p><b>Kriteri 6.</b> Financimi i një programi studimi profesional duhet të sigurojë e të garantojë mbulimin e të gjitha burimeve dhe veprimtarive të qëndrueshme dhe operative, të lidhura e që janë në funksion të realizimit të programit të studimit, duke garantuar njëkohësisht qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit e në vijim.</p>	<p>UET është institucion jo publik i arsimit të lartë në pronësi të shoqërisë tregtare “European Education Initiative” shpk (shkurt “E.E.I.” shpk) për pasojë aktiviteti tregtar rregullohet edhe nga ligji “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”. Sipas statutit, burimet parësore të financimit të UET janë: financimet nga shoqëria tregtare “E.E.I.” shpk; të ardhurat nga tarifat e studimit dhe të ardhurat për shërbime të tjera. Burime dytësore të financimit janë të ardhurat nga shërbime që UET kryen për të tretët; donacione nga sektori publik, nga sektori privat dhe shoqëria civile (kombëtare apo ndërkombëtare); të ardhura nga projektet e aplikuara, si nga dhe burime të tjera ligjore financimi. Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në informacionin e paraqitur në pasqyrat financiare të “E.E.I.” shpk dhe raportet e audituesit ligjor, të marra gjatë vizitës në UET, GVJ konstatoi se për periudhën 2017-2020 struktura e të ardhurave të realizuara paraqitet si vijon:</p> <table border="1" data-bbox="647 1070 1362 1211"> <thead> <tr> <th>Të Ardhurat / Viti</th> <th>2017</th> <th>2018</th> <th>2019</th> <th>2020</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Tarifat e shkollimit</td> <td>96.2%</td> <td>95.1%</td> <td>91.9%</td> <td>94.4%</td> </tr> <tr> <td>Donacionet e ndryshme</td> <td>1.4%</td> <td>2.6%</td> <td>5%</td> <td>3.3%</td> </tr> <tr> <td>Aktivitete tregtare</td> <td>2.4%</td> <td>2.3%</td> <td>3.1%</td> <td>2.3%</td> </tr> </tbody> </table> <p>Në vlera absolute konstatohet një rënie e theksuar e nivelit të të ardhurave kundrejt vitit 2017 me mbi 50%. Vlerësimi i audituesit ligjor për pasqyrat financiare vitin 2020 është pa rezervë kundrejt një vlerësimi me rezervë për vitin 2019. “E.E.I.” shpk rezulton fitimprurëse për vitin financiar 2020 por me një zvogëlim të rëndësishëm në kapitalet e veta (pasojë e humbjeve të mëparëshme).</p> <p><i>GVJ vlerëson se treguesit e mësipërm flasin për një rënie të qëndrueshmërisë financiare dhe rekomandon një analizë më të detajuar të kostove sipas programeve të studimit në funksion të një mirëadministrimi të qëndrueshëm, afatgjatë dhe efektiv të institucionit por edhe të programeve që mbulon.</i></p> <p>[Referenca: 0. RVB_DP Kontabilitet.pdf; 2. Statuti UET.pdf; 0.2. Aneks - Tabelat mbeshetese - DP Kontb.pdf; 2.1-2.3 Pasqyrat Financiare 2018-2020 me shenime.pdf; 2.4-2.6 Raport auditimi</p>	Të Ardhurat / Viti	2017	2018	2019	2020	Tarifat e shkollimit	96.2%	95.1%	91.9%	94.4%	Donacionet e ndryshme	1.4%	2.6%	5%	3.3%	Aktivitete tregtare	2.4%	2.3%	3.1%	2.3%
Të Ardhurat / Viti	2017	2018	2019	2020																	
Tarifat e shkollimit	96.2%	95.1%	91.9%	94.4%																	
Donacionet e ndryshme	1.4%	2.6%	5%	3.3%																	
Aktivitete tregtare	2.4%	2.3%	3.1%	2.3%																	




	viti 2018-2020.pdf; vizita në institucion]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

#### Standardi IV.4

**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek, zbaton politika e procedura institucionale dhe i jep formacion të plotë e të hollësishëm studentëve mbi programin e studimit me karakter profesional, pranimin, përzgjedhjen, përparimin akademik, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton, zbaton dhe bën publike politika, procedura e kritere të qarta e të kuptueshme për pranimit e studentëve, përparimin e tyre përgjatë kursit të studimit, të vlerësimin të dijeve dhe të diplomimit, të cilat garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Bazuar në informacionet e dosjes së vetëvlerësimin, të faqes web zyrtare të UET, si dhe në takimet e realizuara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se politikat dhe procedurat e pranimit, vlerësimin dhe diplomimit të studentëve në përgjithësi, janë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe statutin e UET. Barazia e të drejtave për kandidatët dhe studentët e programit të studimit garantohej edhe nga kriteret specifike të statutit dhe rregullores së UET, si dhe të rregullores mësimore të programit të studimit. Sipas statutit të UET (neni 19 pika 2.7.1.), Senati Akademik i UET miraton çdo vit kërkesat e përgjithshme dhe specifike për pranimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve në programet e studimit, si dhe numrin maksimal të tyre, bazuar në propozimin e njësisë bazë dhe dekanatit që mbulon programin e studimit. Këto kritere dhe kuota të pranimit bëhen publike nga UET përpara fillimit të aplikimeve e për pranimin e studentëve. Në takimin me studentët e këtij program studimi, GVJ konfirmoi bindjen se kandidatët potencialë të këtij program studimi informohen lidhur me ofertën didaktike të UET përmes publikimeve në faqen web zyrtare, në median audio-vizive, përmes publikimit të fletëpalosjeve, posterave, broshurave, si dhe përmes prezantimeve në “Gjimnaz Tour-et” dhe në ambientet e UET që institucioni organizon disa javë para fillimit të vitit akademik.</p> <p>[Referenca: 0. RVB_DP Kontabilitet.pdf; 2. Statuti UET.pdf; 5. Rregullore e UET.pdf; 7. Rregullore e programit te studimit DP Kontabilitet.pdf; 27.1. Dokumenti D.I. Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve.pdf; <a href="https://uet.edu.al/new/sq/aplikimet-dhe-pranimet/">https://uet.edu.al/new/sq/aplikimet-dhe-pranimet/</a>; vizita në institucion]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të përgjithshme dhe/ose të veçanta për pranimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve në programet e studimit me karakter profesional dhe udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me to.</p>	
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në</p>

<p>dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, zhvillimin e veprimtarive praktike e profesionale të programit dhe institucionet bashkëpunuese në këto veprimtari, vlerësimin të dijeve e aftësive të studentëve dhe diplomimit.</p>	<p>informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion dhe nga faqja web zyrtare e UET, GVJ konkludon se studentët e programit të studimit “Diplomë Profesionale në Kontabilitet” informohen nga pedagogët përkatës dhe Kordinatori i Departamentit të Ekonomiksit dhe Financës për të gjitha detajet që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe elementët ndihmës në funksion të këtij procesi. Në fillim të çdo viti akademik, organizohet java orientuese për studentët e rinj, ku përmes takimeve dhe leksioneve sqarohet sistemi i studimeve, rregulloret dhe procedurat administrative të UET. Gjithashtu nga takimi me studentët rezultoi se ky process informimi vijon në mënyrë periodike edhe në fillim të çdo semestri mësimor.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit të studimeve, mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesi ndaj Studentit (ZKKKS) ishte struktura që kujdesej edhe për informimin e studentëve mbi mundësitë e punësimit në fund të ciklit të studimeve. Nga takimi me përfaqësuesen e kësaj zyre rezultoi se ZKKKS në bashkëpunim edhe me strukturat e tjera të UET, informon, orienton dhe mbështet studentët e UET, duke krijuar mundësi për realizimin e trajnimeve të ndryshme, internship-eve, duke lehtësuar komunikimin me tregun e punës si edhe duke ndjekur ecurinë e tyre pas diplomimit. Aktivitetet me Bordin e Tregut të Punës dhe organizimi i Panairëve të Punës që realizohen nga kjo zyrë, në bashkëpunim me strukturat e tjera administrative të UET, si dhe me stafin akademik, u japin mundësi studentëve të UET të familjarizohen me tregun e punës dhe kërkesat e tij.</p> <p><i>[Referenca: 0. RVB_DP_Kontabilitet.pdf; 5. Rregullore e UET.pdf; 7. Rregullore e programit te studimit DP Kontabilitet.pdf; 12.3. Poster_Panairi i punës 2018 dhe 2019.pdf; <a href="https://uet.edu.al/new/sq/keshillimi-i-karrieres/">https://uet.edu.al/new/sq/keshillimi-i-karrieres/</a>; vizita në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen, veprimtaritë formuese dhe informacion të gjerë e të përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të</p>	<p>GVJ konstatoi se kordinatori dhe pedagogët e departamentit të Ekonomiksit dhe Financës luajnë një rol të rëndësishëm në informimin dhe përditësimin e studentëve lidhur me zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të këtij programi studimi.</p> <p>GVJ konstatoi se përveç rregulloreve përkatëse, në</p>



tij.	dispozicion të studentëve janë edhe udhëzues e materiale informuese si fletëpalosje dhe broshura të përgatitura për programet e studimit, organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën, shërbimet dhe aktivitete të tjera, të vendosura në ambientet dhe në faqen zyrtare web të institucionit.			
<b>Kriteri 6.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Nëpërmjet sistemit të menaxhimit online të mësimdhënies UET LMS, me bazë në Moodle, studentët e këtij programi studimi mund të konsultojnë përmes llogarive individuale edhe në distancë udhëzuesit për studentët, informacione të përditësuara mbi syllabuset, veprimtaritë mësimore, grafikun dhe rezultatet e provimeve, si edhe materialet e postuara nga pedagogët sipas lëndëve përkatëse.  [Referenca: 0. RVB_DP Kontabilitet.pdf; 5. Rregullore e UET.pdf; 7. Rregullore e programit të studimit DP Kontabilitet.pdf; 46.3. UET LMS Guide per studentet.pdf; <a href="https://lms.uet.edu.al/course/index.php">https://lms.uet.edu.al/course/index.php</a> ; vizita në institucion]			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X


#### Standardi IV.5

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin e daljen në tregun e punës.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në UET, GVJ konstatoi se administrimi i gjithë informacionit lidhur me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim realizohet nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit të Informacionit të UET (UMIS) si dhe në mënyrë manuale në formatin e dosjeve/regjistrave përkatës. Sistemi UMIS administrohet nga Zyra e Teknologjisë së Informacionit, strukturë në varësi të Administratorit të UET. Hyrja/përdorimi i sistemit UMIS realizohet nëpërmjet një autorizimi të dedikuar për secilin përdorues. Sistemi UMIS është i organizuar në disa module: moduli i regjistrimit të studentëve, moduli i orarit, moduli i statistikave & moduli i menaxhimit të lëndëve dhe programeve. Gjithashtu pranë strukturës së Sekretarit të Përgjithshëm dhe zyrës së Sekretarisë Mësimore gjendet

	<p>edhe dokumentacioni dhe arkiva letër në formën e dosjeve të plota për secilin student të UET. Gjatë takimit me sekretarinë GVJ verifikoi me zgjedhje dosjen fizike të dy studentëve të programit të studimit “Diplomë Profesionale në Kontabilitet” dhe konstatoi plotësinë e tyre si dhe përdorimin e regjistrave përkatës (themeltar &amp; të arritjeve akademike) sipas kërkesave të kuadrit ligjor në fuqi.</p> <p><i>[Referenca: 0. RVB_DP Kontabilitet.pdf; 2. Statuti UET.pdf; 5. Rregullore e UET.pdf; 46. Manuali i perdoruesit te sistemit UMIS.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe të partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe të marrë në takimet gjatë vizitës në UET, GVJ konstatoi se administrimi i informacionit për personelin e angazhuar në këtë program studimi realizohet nga disa struktura në varësi të natyrës së informacionit.</p> <p>Përmes sistemeve UMIS dhe LMS, Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës dhe struktura të tjera të interesuara, menaxhojnë informacionin lidhur me aktivitetin mësimor të personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, si dhe komunikimet me studentët përkatës. Zyra e Burimeve Njerëzore administron në mënyrën tradicionale (arkiva letër) dosjet e plota personale të të gjithë personelit të UET, ndërsa Zyra e Financës administron informacionin lidhur me pagesat etj. GVJ konstatoi se informacioni në dosjet përkatëse përditësohet rregullisht për të reflektuar ndryshimet e ndodhura në kualifikime, pozicione, kontrata etj.</p> <p><i>[Referenca: 0. RVB_DP Kontabilitet.pdf; 2. Statuti UET.pdf; 5. Rregullore e UET.pdf; 46. Manuali i perdoruesit te sistemit UMIS.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në UET, GVJ konstatoi se sistemi UMIS ofron funksionalitetet e nevojshme të komunikimit kryesisht për aspektet administrative të universitetit si: regjistrimet, tarifat, grafiku i provimeve, rezultatet deri në diplomim sipas cikleve të studimit etj. Ndërsa sistemi LMS ofron funksionalitetet e nevojshme të komunikimit për aspektet mësimore të ciklit akademik të studimeve universitare si: programet mësimore sipas cikleve të studimit, syllabuset dhe materialet ndihmëse sipas lëndëve përkatëse, informacione mbi detyrat e kursit, detyrimet e tjera, oraret mësimore &amp; të provimeve, vlerësimet sipas</p>

	<p>tipologjive, forume diskutimi, njoftime të ndryshme etj.</p> <p>GVJ konstatoi se hyrja dhe përdorimi i sistemeve UMIS dhe LMS realizohet nëpërmjet një autorizimi të dedikuar (llogari individuale) për secilin përdorues. Gjithashtu për shkak të Pandemisë Covid-19, gjatë vitit akademik 2020-2021, UET ka integruar edhe përdorimin e platformës Microsoft Teams kryesisht për mësimdhënien online.</p> <p><i>[Referenca: 0. RVB_DP Kontabilitet.pdf; 46. Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS.pdf; 46.2. UET LMS Guide per pedagogun.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>GVJ gjykon se në tërësi sistemi i kombinuar menaxhimit të informacionit i UET (UMIS, LMS &amp; Microsoft Teams) garanton monitorimin e aktivitetit akademik dhe administrativ të institucionit si dhe mundëson evidentimin në kohë të problematikave dhe marrjen e masave për përmirësim nga strukturat përkatëse. Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në UET, GVJ konstatoi se në fund të semestrit Zyra e IT (përgjegjëse për administrimin e sistemeve) harton një raport mbi aktivitetin e pedagogëve në platformat interactive, si informacion për organet drejtuese të UET.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p><i>Megjithatë formati i raportit i paraqitur në DVV është shumë i përgjithshëm dhe në nivel universiteti. GVJ nuk konstatoi ndonjë formë raporti të dedikuar sipas programeve të studimit. Një pjesë e njoftimeve në platformën LMS rezultojnë të vjetëruara tashmë (mars 2020).</i></p> <p><i>[Referenca: 0. RVB_DP Kontabilitet.pdf; 46. Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS.pdf; 46.2. UET LMS Guide per pedagogun.pdf; 46.3. UET LMS Guide per studentet.pdf; 46.5. Raport ecuria e mësimin online.pdf; <a href="https://lms.uet.edu.al/">https://lms.uet.edu.al/</a>; vizita në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>GVJ konstatoi se në faqen zyrtare web të UET publikohet në gjuhën shqipe informacioni i nevojshëm mbi programet e studimit të ofruara, personelin akademik, aktivitetet e realizuara, si dhe shërbimet e njoftime të tjera për të gjithë të interesuarit. Gjithashtu rubrikat kryesore të këtij informacioni, kryesisht titujt dhe pjesa hyrëse në disa raste, janë edhe në gjuhën angleze.</p> <p><i>GVJ rekomandon që paraqitja e informacionit në faqen zyrtare web në gjuhën angleze të jetë e plotë dhe jo vetëm</i></p>




	<i>për titujt kryesorë.</i> [Referenca: <a href="https://uet.edu.al/new/sq/diploma-profesionale/">https://uet.edu.al/new/sq/diploma-profesionale/</a> ]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin, në programin e studimit dhe i vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit.	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika, procedura dhe kriteret të pranimit, përparimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit të studentëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore dhe që janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në Statutin dhe Rregulloret e UET, si dhe informacionin e faqes web zyrtare të institucionit, GVJ konkludon se politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin akademik të studentëve janë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e tjera rregullatore.  Sipas statutit të UET ( <i>neni 19 pika 2.7.1.</i> ), Senati Akademik i UET miraton çdo vit kërkesat e përgjithshme dhe specifike për pranimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve në programet e studimit, si dhe numrin maksimal të tyre, bazuar në propozimin e njësisë bazë dhe dekanatit që mbulon programin e studimit. Këto kriteret dhe kuota të pranimit bëhen publike nga UET përpara fillimit të aplikimeve e për pranimin e studentëve. Barazia e të drejtave për kandidatët dhe studentët e programit të studimit garantohej edhe nga kriteret specifike të statutit dhe rregullores së UET, si dhe të rregullores mësimore të programit të studimit. Në takimin me studentët e këtij programi studimi dhe nga faqja web e UET, GVJ konstatoi se procedurat dhe kriteret e përdorura në përzgjedhjen e studentëve, në vlerësimin përgjatë ciklit të studimeve e më pas, deri në diplomim, janë lehtësisht të kuptueshme dhe të disponueshme për të gjithë të interesuarit.
<b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje dhe orientimin drejt tregut të punës, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	
[Referenca: 0. RVB_DP Kontabilitet.pdf; 2. Statuti UET.pdf; 5.	

	<i>Rregullore e UET.pdf; 7. Rregullore e programit te studimit DP Kontabilitet.pdf; 27.1. Dokumenti D.I. Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimet të studentëve.pdf; <a href="https://uet.edu.al/new/sq/aplikimet-dhe-pranimet/">https://uet.edu.al/new/sq/aplikimet-dhe-pranimet/</a>; vizita në institucion]</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve dhe, përpara fillimit të çdo viti akademik, udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, dokumentacionit shoqërues dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion lidhur me pranimin e studentëve të rinj, GVJ konstatoi se UET harton dhe publikon në fillim të çdo viti akademik kriteret e veçanta dhe të përgjithshme për përzgjedhjen e kandidatëve për pranim sipas secilit program dhe cikël studimesh, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.</p> <p>Kandidatët potencialë të këtij programi studimi informohen lidhur me ofertën didaktike të UET përmes publikimeve në faqen web zyrtare, në median audio-vizive, përmes publikimit të fletëpalosjeve, posterave, broshurave, si dhe përmes prezantimeve në “Gjimnaz Tour-et” që institucioni organizon disa javë para fillimit të vitit akademik. GVJ konstatoi se për programin e studimit “Diplomë Profesionale në Kontabilitet”, nuk ka kritere të veçanta apo të tjera për përzgjedhjen e kandidatëve, përveç kriterëve të përgjithshme të parashikuara nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi.</p> <p><i>[Referenca: 0. RVB_DP Kontabilitet.pdf; 7. Rregullore e programit te studimit DP Kontabilitet.pdf; 27.1. Dokumenti D.I. Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimet të studentëve.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, kalimit nga një vit akademik në tjetrin, procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, dokumentacionit shoqërues, informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion dhe të paraqitur në faqen zyrtare web të UET, GVJ vlerëson se në dispozicion të studentëve vihet informacion i plotë lidhur me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të tyre, vlerësimit të dijeve e aftësive të marra, si dhe kriteret e diplomimit në programin e studimit “Diplomë Profesionale në Kontabilitet”.</p>
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit dhe diplomimit në programin e studimit.	<p>Konkretisht GVJ konstatoi se në “Rregulloren Mësimore të Programit të Studimit” jepet informacion i plotë mbi kriteret e pranimet të studentëve në programin e studimit, strukturën e programit, kreditet, kontrollin e dijeve, kushtet e kalimit në vitet pasuese deri në diplomim, si dhe mbi procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme në rast transferimi studimesh. Studentët e këtij programi studimi informohen në lidhje me programin e studimit, organizimin e vitit akademik dhe kuadrin rregullator përkatës që në momentin e</p>






	<p>regjistrimit pranë UET, si dhe më pas në mënyrë të vazhdueshme nga stafi akademik i Departamentit të Ekonomiksit dhe Financës, nga sekretaria mësimore e UET, nga specialistët e shërbimit të Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit, si dhe nëpërmjet platformave UMIS &amp; LMS.</p> <p>[Referenca: 0. RVB_DP Kontabilitet.pdf; 2. Statuti UET.pdf; 5. Rregullore e UET.pdf; 7. Rregullore e programit te studimit DP Kontabilitet.pdf; 12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.pdf; vizita në institucion]</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Gjithashtu GVJ konstatoi se në fillim të vitit akademik, Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit, në bashkëpunim me stafin akademik dhe strukturat ndihmëse të UET, përgatit, përditëson dhe publikon në faqen web të UET, rrjetet sociale, si dhe në takime apo mbledhje të hapura me grupe të ndryshme interesi, fletëpalosje, postera, broshura dhe udhëzues të tjerë informues mbi programet e studimit të UET.</p> <p>[Referenca: 0. RVB_DP Kontabilitet.pdf; 5. Rregullore e UET.pdf; 7. Rregullore e programit te studimit DP Kontabilitet.pdf; 12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.pdf; vizita në institucion]</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

**Standardi V.2**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni informon në mënyrë të hollësishme studentët për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe ve në dispozicion të tyre, informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, si dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konkludon se studentët e programit të studimit “Diplomë Profesionale në Kontabilitet” informohen nga pedagogët përkatës, Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit she sekretaria mësimore për të gjitha detajet që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe elementët ndihmës në funksion të këtij procesi. GVJ konstatoi se përveç rregulloreve përkatëse, në dispozicion të studentëve janë edhe</p>

<p>studimit me karakter profesional.</p>	<p>udhëzues e materiale informuese si fletëpalosje dhe broshura të përgatitura mbi organizimin dhe strukturën e programit të studimit të vendosura në ambientet e UET dhe në faqen zyrtare web të institucionit. Përmes hapësirës së dedikuar në platformat LMS dhe UMIS të UET mund të konsultohen online nga studentët të gjitha informacionet e përditësuara mbi programet, veprimtaritë mësimore, oraret dhe rezultatet e provimeve etj.</p> <p><i>[Referenca: 0. RVB_DP Kontabilitet.pdf; 46. Manuali i perdoruesit te sistemit UMIS.pdf; 46.2. UET LMS Guide per pedagogun.pdf; 46.3. UET LMS Guide per studentet.pdf; 12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët mbi praktikat profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit (ZKKKS) ishte struktura që kujdesej kryesisht për informimin e studentëve mbi mundësitë e punësimit në fund të ciklit të studimeve.</p> <p>Nga takimi me përfaqësuesen e kësaj zyre rezultoi se ZKKKS në bashkëpunim edhe me kordinatorët e çdo departamenti të UET, informon, orienton dhe mbështet studentët e UET, duke krijuar mundësi për realizimin e praktikave dhe trajnimeve të ndryshme, duke lehtësuar komunikimin me tregun e punës si edhe duke ndjekur ecurinë e tyre pas diplomimit.</p> <p><i>[Referenca: 0. RVB_DP Kontabilitet.pdf; 12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>GVJ konstatoi se sekretaria mësimore, kordinatori dhe pedagogët e departamentit të Ekonomiksit dhe Financës luajnë një rol të rëndësishëm në informimin dhe përditësimin e studentëve lidhur me zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të këtij programi studimi.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>GVJ konstatoi se përveç rregulloreve përkatëse, në dispozicion të studentëve janë edhe udhëzues e materiale informuese si fletëpalosje dhe broshura të përgatitura për programet e studimit, organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën, shërbimet dhe aktivitete të tjera, të vendosura në ambientet dhe në faqen zyrtare web të institucionit. Nëpërmjet sistemit të menaxhimit online të</p>



	<p>mësimdhënies UET LMS, me bazë në Moodle, studentët e këtij programi studimi mund të konsultojnë përmes llogarive individuale edhe në distancë udhëzuesit për studentët, informacione të përditësuara mbi syllabuset, veprimtaritë mësimore, grafikun dhe rezultatet e provimeve, si edhe materialet e postuara nga pedagogët sipas lëndëve përkatëse.</p> <p>[Referenca: 0. RVB_DP Kontabilitet.pdf; 5. Rregullore e UET.pdf; 7. Rregullore e programit të studimit DP Kontabilitet.pdf; 46.3. UET LMS Guide per studentet.pdf; <a href="https://lms.uet.edu.al/course/index.php">https://lms.uet.edu.al/course/index.php</a>; vizita në institucion]</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Niveli i përmbushjes</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi V.3</b>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit me karakter profesional, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.</b></p>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve në vitet paraardhëse në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se UET mban dhe disponon statistika vjetore mbi numrin e studentëve të regjistruar dhe diplomuar sipas programeve dhe cikleve të studimit. Strukturat si Sekretaria Mësimore, Zyra e Këshillimit të Karrierës &amp; Kujdesit ndaj Studentit, Shoqata Alumni, struktura në varësi të zv/Rektorit për Çështjet Akadematike &amp; Kërkimin Shkencor, administrojnë të gjithë informacionin lidhur me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim për çdo program studimi si dhe ecurinë e tyre në punësimin pas diplomimit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Gjatë vizitës në UET, GVJ konstatoi se regjistrat e sekretarisë mësimore (themeltar, i arritjeve akademike dhe ai i dhënies së diplomave) janë të formatuar sipas standardeve ligjore në fuqi. Pranë sekretarisë depozitohet edhe dokumentacioni i përgatitur nga personeli akademik lidhur me frekuentimin e studentëve dhe procesverbalet e vlerësimeve sipas lëndëve.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre, përfshirë punësimin eventuale të tyre.</p>	<p>Meqë programi i studimit “Diplomë Profesionale në Kontabilitet” ka filluar në vitin 2018, në këtë program</p>

	<p>studimi kanë përfunduar detyrimet akademike vetëm një brez studentësh. Nga statistikat aktuale mësimore lidhur me këtë program studimi, për tre vitet e para të funksionimit të këtij programi rezultojnë të ketë patur disa studentë të çregjistruar nga programi. Të gjithë studentët e regjistruar në këtë program studimi janë të regjistruar me numër matrikullimi.</p> <p>Gjithashtu gjatë vizitës, GVJ verifikoi me zgjedhje dosjet personale dhe të ecurisë akademike të dy studentëve të programit të studimit “Diplomë Profesionale në Kontabilitet” dhe konstatoi plotësinë e tyre.</p> <p>Të dhënat për regjistrimin e studentëve në këtë program studimi për periudhën 2018-2021 paraqiten si vijon:</p> <table border="1" data-bbox="628 703 1362 893"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Të regjistruar</th> <th>Të çregjistruar</th> <th>Të diplomuar</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2018-2019</td> <td>7 studentë</td> <td>2 studentë</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>2019-2020</td> <td>26 studentë</td> <td>3 studentë</td> <td>në proces</td> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> <td>5 studentë</td> <td>-</td> <td>në proces</td> </tr> </tbody> </table> <p>GVJ konstaton se shifrat e regjistrimeve në këtë program studimi gjatë harkut kohor 2018-2020 flasin për një paqëndrueshmëri në numrin e regjistrimeve.</p> <p><i>[[Referenca: 0. RVB_DP Kontabilitet.pdf; 9. Dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore.pdf; 12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.pdf; 27. Cilesia ne hyrje dhe dalje per programin.pdf; vizita në institucion]</i></p>	Viti akademik	Të regjistruar	Të çregjistruar	Të diplomuar	2018-2019	7 studentë	2 studentë	2	2019-2020	26 studentë	3 studentë	në proces	2020-2021	5 studentë	-	në proces
Viti akademik	Të regjistruar	Të çregjistruar	Të diplomuar														
2018-2019	7 studentë	2 studentë	2														
2019-2020	26 studentë	3 studentë	në proces														
2020-2021	5 studentë	-	në proces														
<p><b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>GVJ konstatoi se ruajtja dhe menaxhimi i të dhënave statistikore të studentëve realizohet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe kërkesat e statutit dhe rregulloreve të UET.</p> <p>Zyra e Sekretarisës Mësimore dhe Zyra e Teknologjisë së Informacionit kujdesen drejtpërdrejt për ruajtjen e informacionit në formatin letër (në arkivë fizike) dhe në versionin elektronik (në sistemin e brendshëm UMIS). Të dyja mënyrat e ruajtjes lehtësojnë kontrollin dhe përdorimin e të dhënave nga personat e autorizuar, si edhe japin siguri lidhur me respektimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale.</p> <p><i>[Referenca: 0. RVB_DP Kontabilitet.pdf; 9. Dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore.pdf; vizita në institucion]</i></p>																
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion,</p>																

<p>dalje të studentëve, si dhe të shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>rezultoi se Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit është struktura përgjegjëse për hartimin e raporteve periodike mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve sipas lëndëve dhe programeve të studimit.</p> <p>Përveç tabelës përmbledhëse për punësimin e dy studentëve të diplomuar, GVJ nuk konstatoi ndonjë raport apo analizë tjetër të kësaj natyre lidhur me programin e studimit “Diplomë Profesionale në Kontabilitet” apo programe të ngjashme.</p> <p><i>Gjykojmë se pavarësisht të dhënave të kufizuara, një analizë e tillë do të ishte e nevojshme për të mundësuar një vlerësim sa më objektiv të programit të studimit dhe marrjen e masave nga UET në funksion të përmirësimit të tij në të ardhmen.</i></p> <p>[Referenca: 0. RVB_DP Kontabilitet.pdf; 12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.pdf; 29. Tabele përmbledhëse për punësimin real të studenteve.pdf; vizita në institucion]</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	


<p><b>Standardi V.4</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, rezultoi se UET në përputhje me legjislacionin në fuqi, statutin dhe rregulloren e institucionit ka mundësuar ngritjen e Këshillit Studentor të UET, si dhe angazhimin e përfaqësuesve të studentëve në Senatin Akademik të UET dhe në Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të UET. GVJ konstatoi se në statutin e UET (neni 19 pika 2.4 dhe neni 51) dhe në rregulloren përkatëse (neni 42 pikat d, e) parashikohet qartë garantimi i përfshirjes së studentëve në procesin e vendimmarrjes me përfaqësuesit e tyre të zgjedhur me mandat 2-vjeçar në një proces transparent. Konkretisht sipas statutit të UET, kryetari i Këshillit Studentor dhe dy studentë të tjerë, përfaqësues nga të tre ciklet e studimit dhe</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose e përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	

	<p>të zgjedhur nga këshilli, janë anëtarë të Senatit Akademik të UET. Gjithashtu një student, si përfaqësues i Këshillit Studentor, është anëtar i Komisionit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të UET. Gjatë takimeve të zhvilluara në institucion, GVJ mori konfirmimin lidhur me kontributin e studentit në grupin e punës për hartimin e raportit të vetëvlerësimit si dhe përfshirjen e rregullt të opinioneve të studentëve përmes pyetësorëve, fokus-grupeve dhe takimeve/mbledhjeve të hapura.</p> <p><i>[Referenca: 0. RVB_DP Kontabilitet.pdf; 2. Statuti UET.pdf; 5. Rregullore e UET.pdf; 8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë.pdf; 30.4. Urdhër administrativ mbi përbërjen e KSBC.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe informacionit të marrë gjatë takimit me stafin akademik të departamentit të Ekonomiksit dhe Financës, rezultoi se në hartimin dhe programin e studimit “Diplomë Profesionale në Kontabilitet” është mbajtur parasysh ngarkesa akademike e studentëve. Aktualisht për këtë kategori program studimi nuk është i mundur transferimi i studentëve, si nga jashtë UET ashtu dhe ndërmjet programeve brenda UET, por syllabuset e lëndëve dhe shpërndarja përkatëse e krediteve është strukturuar në mënyrë të tillë që t’u lehtësojë edhe këtë proces nëse do të jetë e mundur nga pikpamja rregullatore në të ardhmen. Përveç përfshirjes së studentëve në vendimmarrje, përmes strukturave të garantuara nga statuti dhe rregullorja e UET, GVJ konstatoi se aktualisht institucioni përdor rregullisht sipas një plani veprimi për sigurimin e brendshëm të cilësisë në UET pyetësorin online për studentët, fokus grupet, si dhe monitorime të ndryshme (për ankesat e studentëve, për të vlerësuar pjesëmarrjen e tyre etj). Si rregull, rezultatet e gjithë sa më sipër janë objekt diskutimi në strukturat përkatëse të UET dhe bëhen pjesë e analizës vjetore dhe planit të masave për përmirësim që ndërmerr departamenti në përgjithësi dhe në lidhje me programin e studimit në veçanti.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p><i>[Referenca: 0. RVB_DP Kontabilitet.pdf; 2. Statuti UET.pdf; 5. Rregullore e UET.pdf; 8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë.pdf; 30.1. Plani veprimi KSBC.pdf; 30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë.pdf; 40. G-III-4-2 Format i vlerësimit të pedagogut nga studentët.pdf; 40.1. D-VI-3-3 Formular për ankesat e studentëve.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet</p>	<p>GVJ konstatoi se në rregulloret e UET parashikohet e drejta e</p>

<p>të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>çdo studenti për të dhënë mendim lidhur me cilësinë e mësimdhënies dhe të punës së personelit akademik (rregullorja mësimore UET neni 42 pika f) si dhe e drejta e ankimimit lidhur me procesin e vlerësimit dhe kontrollit të njohurive apo përbërës të tij (neni 32 i rregullores mësimore UET &amp; pika 5.8 e rregullores së programit të studimit) duke garantuar barazi dhe transparencë në rivlerësim. Gjithashtu studentët në fund të çdo semestri, mund të përdorin edhe pyetësorët përkatës për të shprehur mendimin e tyre lidhur me cilësinë e procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve.</p> <p>[Referenca: 5. Rregullore e UET.pdf; 7. Rregullore e programit të studimit_DP Kontabilitet.pdf; 40. G-III-4-2 Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët.pdf; 40.1. D-VI-3-3 Formular për ankesat e studentëve.pdf; vizita në institucion]</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi V.5</b></p>	
<p><b>Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>GVJ konstatoi se në rregulloret e UET parashikohen qartë procedurat dhe strukturat/zyrat e dedikuara në shërbim të studentëve si struktura e Këshillimit Karrierës dhe Kujdesi ndaj Studentit (KKKS) e përbërë nga Zyra e Këshillimit të Karrierës, Zyra e Kujdesit ndaj Studentit dhe Zyra e Pranimeve. Struktura e KKKS është pjesë përbërëse e strukturës administrative të UET në varësi të drejtpërdrejtë të Zëvendës-Rektorit për Çështjet Akademike dhe Kërkimin Shkencor. Konkretisht, Zyra e Kujdesit ndaj Studentit është njësi e dedikuar në shërbim të informimit të studentëve rreth mundësive të studimit, mbi kuadrin rregullator, mbi ecurinë deri në diplomim, përfitimin e bursave, aplikimin në projekte dhe aktivitete të tjera të ngjashme. Pranë çdo departamenti funksion tutoriati dhe këshillimi akademik, gjatë të cilit studentët mund të këshillohen më tej lidhur me programin mësimor, detyrimet akademike, politikat dhe procedurat e institucionit, mundësitë dhe shërbimet që ofrohen, për një</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Në institucion është ngritur dhe funksionon një sistem i posaçëm për mirëpritjen, informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	

	<p>ecuri sa më pozitive pranë UET.</p> <p>Së bashku me sekretarinë mësimore dhe kordinatorin e departamentit, këto struktura/zyra ndjekin të gjitha procedurat, aktivitetet dhe mbajnë e përditësojnë dokumentacionin që ka lidhje të drejtëpërdrejtë me procesin mësimor si dhe garantojnë informimin, këshillimin dhe ndjekjen e ecurisë së studentëve sipas programeve të studimit në nivel Fakulteti dhe në nivel Universiteti.</p> <p><i>[Referenca: 5. Rregullore e UET.pdf; 7. Rregullore e programit të studimit_ DP Kontabilitet.pdf; 12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.pdf; 27.2. Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Përmes zyrës/njesisë për këshillimin e karrierës, institucioni mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm lidhur me plotësimin e detyrimeve të procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, organigramës dhe rregulloreve të UET, rezultoi se shërbimi i këshillimit të karrierës ofrohet kryesisht nga Zyra e Këshillimit të Karrierës pjesë e strukturës së KKKS.</p> <p>Gjatë takimit me përfaqësuesen e zyrës, GVJ konstatoi se veprimtaria e kësaj zyre në bashkëpunim me strukturat e tjera të institucionit, si dhe shoqatën Alumni UET e Klubet Studentore, përfshinte sigurimin e informacioneve orientuese dhe ofrimin e zgjidhjeve për çështjet që lidhen me zhvillimin e karrierës së studentëve potencialë, të studentëve aktualë të UET si dhe gjurmimin e të diplomuarve pas përfundimit të studimeve. Gjithashtu kjo zyrë përgatit kalendarin e eventeve si Open Day për Fakultetet dhe Panairët e Punës, zhvillon sondazhe për planet e karrierës së studentëve, të besnikërisë ndaj UET, aktivitete me rrjetin Alumni dhe Bordet e Tregut të Punës etj. Për shkak të pandemisë Covid-19, gjatë vitit të fundit aktiviteti i zyrës ka qenë relativisht i kufizuar dhe i fokusuar kryesisht në platformën online të UET. Në hapësirën e dedikuar të faqes zyrtare web të UET, gjenden të publikuara aktivitete dhe publikime të tjera informuese që synojnë lehtësimin e punësimit apo të kryerjes së praktikave profesionale të studentëve, si dhe për identifikimin e nevojave të bizneseve për konsulencë, trajnime, kërkime etj (Programi 500+). Statistikat e përgatitura nga kjo zyrë për programin e studimit “Diplomë Profesionale në Kontabilitet”, për shkak të numrit të vogël të të diplomuarve (vetëm 2 studentë) janë</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit, ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse dhe merr masa për përmirësimin e shkallës dhe cilësisë së punësimit të tyre.</p>	





	<p>të thjeshta.</p> <p><i>GVJ këshillon kryerjen e analizave sipas programeve të studimit, lidhur me punësimin e studentëve pas diplomimit dhe krijimin e një database të integruar informacioni në shërbim të studentëve dhe strukturave të UET për të përmirësuar cilësinë e punësimit të studentëve dhe të programeve të studimit, por edhe për të lehtësuar procesin e rekrutimit nga punëdhënësit.</i></p> <p><i>[Referenca: 5. Rregullore e UET.pdf; 7. Rregullore e programit të studimit_ DP Kontabilitet.pdf; 12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.pdf; <a href="https://uet.edu.al/new/sq/punesim-internship-per-studente/">https://uet.edu.al/new/sq/punesim-internship-per-studente/</a>; <a href="https://uet.edu.al/new/sq/programi-500/">https://uet.edu.al/new/sq/programi-500/</a>; vizita në institucion]</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit me karakter profesional në “Kontabilitet”**

**a. Pikat e forta dhe afirmime;**

1. Mësimdhënia në Institucion është e fokusuar drejt studentit dhe mbështetet gjerësisht në përdorimin e sistemeve të informacionit që lehtësojnë komunikimin interaktiv mes pedagogëve dhe studentëve;
2. Stafi akademik i Institucionit ka kualifikimin dhe përvojën e nevojshme në ofrimin e një larmie programesh studimi të ngjashme në fushat e financës, kontabilitetit dhe auditimit;
3. Programi i studimit është i fokusuar në aspekte praktike dhe aplikative të financës dhe kontabilitetit duke kontribuar në plotësimin e nevojave të tregut aktual të punës për specialistë të niveli bazë në këto fusha;
4. Institucioni ka një portofol të pasur me projekte dhe marrëveshje bashkëpunimi, kombëtare dhe ndërkombëtare;


**b. Pika të dobta;**

1. Mungesa e një studimi të formalizuar tregu, lokal dhe kombëtar, në lidhje me programin e studimit apo të ngjashme;
2. Kurrikula e programit të studimit përmban shumë lëndë të formimit të përgjithshëm duke hequr mundësinë e përfshirjes së lëndëve më specifike dhe praktike të profesionit;
3. Kryerja e praktikës profesionale në auditor, pavarësisht marrëveshjeve të bashkëpunimit me bizneset, pengon familjarizmin e studentëve me mjedisin real të punës;
4. Mungesa e analizave të plota të aktivitetit të kryer nga departamenti, si edhe mungesa e analizës mbi përfitimet konkrete të Institucionit dhe efektivitetin nga marrëveshjet dhe projektet e bashkëpunimit;

**Rekomandime:**

1. Hartimi i një studimi tregu të dedikuar për programin e studimit, duke formalizuar dhe dokumentuar edhe opinionet e mbledhura nga grupet e interesit dhe partnerët në bashkëpunime;
2. Rishikimi i Planit Mësimor për ta lehtësuar, brenda kufijve të lejuar nga kuadri ligjor në fuqi, nga lëndët e formimit të përgjithshëm dhe për ta pasuruar me lëndë më afër profesionit dhe praktikës kontabël dhe financiare;
3. Kryerja e praktikës profesionale në një ambient real pune duke përfituar nga marrëveshjet e bashkëpunimit me shumë Institucione;
4. Hartimi i raporteve më të plota të analizës së aktivitetit, sipas strukturave dhe niveleve njësi bazë, njësi kryesore dhe në nivel institucioni. Si edhe përgatitja e raporteve të plota të analizës së përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit;
5. Hartimi i raporteve financiare sipas programeve të studimit, për një vlerësimin objektiv të aktivitetit të institucionit dhe vijueshmërisë së tij;
6. Rritja e numrit të stafit të dedikuar vetëm në aktivitetin administrativ dhe ndihmës do të lehtësonte personelin akademik dhe do të mundësonte që ky i fundit të fokusohet më shumë në punë akademike – kërkimore dhe shkencore;

**Conclusions of the Evaluation of the study program with professional profile in "Accounting"**



**a. Strengths and affirmations:**


1. Teaching at this HEI is student-centered and relies extensively on the use of information systems that facilitate interactive communication between faculty and students;
2. The academic staff has the necessary qualification and experience in providing a variety of similar study programs in the fields of finance, accounting, and auditing;
3. The study program is focused on practical and applied aspects of finance and accounting, thus contributing to meet the needs of the current job market for entry level specialists in these fields;
4. The institution has a rich portfolio of projects and cooperation agreements, both nationally and internationally;

**b. Weak points:**

1. Lack of a formalized local and national market study related to this study program or similar;
2. The curriculum of this study program contains many subjects of general interest, limiting the possibility of including more specific and practical subjects of the profession;
3. Conducting professional practice in the classroom, despite collaboration agreements with companies, hinders the students' familiarity with the real working environment;
4. Lack of complete analysis of the activity carried out by the department, as well as lack of formal analysis on the benefits and effectiveness of cooperation agreements and projects;

**Recommendations:**

1. Conduct a market study dedicated to the study program, formalizing and documenting the opinions collected from stakeholders and partners in collaborations;
2. Revision of the current curriculum, within the limits allowed by the regulatory framework, in order to facilitate it from the subjects of general interest and to enrich it with subjects closer to the profession and accounting and financial practice;
3. Conducting the professional practice in a real working environment, making use of collaboration agreements with numerous institutions;
4. Compilation of more complete analysis reports of the activities, according to the structures and other levels of organization of the institution. As well as the preparation of comprehensive reports analyzing the benefits and effectiveness of cooperation agreements and projects;
5. To prepare financial reports according to study programs, for a more objective assessment of the institution's activity and its continuity;



6. To increase the number of staff dedicated to administrative and support activities only, in order to facilitate academic staff and allow them to focus better on academic work - teaching and scientific research;

**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit të studimit me karakter profesional “Kontabilitet”**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

